# GAZETA SHQIPTARE




Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7628 E mërkurë 22 Gusht 2018 **Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)**




Dje në "Deutsche Welle"

Nga BERND RIEGERT

## Shansi i dytë i Greqisë



Për tetë vjet me radhë BE demonstroi solidaritet të madh dhe tregoi që është e mundur që së bashku të arrihen rezultate të habitshme. Riparimi i rastit ... Vijon në faqen 20

Opinioni i Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI

## Lira turke, euro dhe dollari i fortë



Turqia është ekonomia e 17-të më e madhe e botës dhe partneri ynë i tretë tregtar për nga importet që bëjmë. Ajo ka një treg 80 milionë banorë dhe një ... Vijon në faqen 21

### EMRAT/ NDERTIMET PA LEJE, LISTA E PRONAREVE TE RINJ NE KRYEQYTET

# LEJET E LEGALIZIMIT PER 700 FAMILJE NE TIRANE

Procedura për certifikatën e pronësisë do të ndiqet nga ALUIZNI. Sipërfaqja e legalizuar s'mund të jetë më e madhe se 3-fishi i ndërtimit



*(Në foto)* Zonë informale

Në faqet 8-9







FOTOT/ Qindra të ftuar në evenimentin muzikor

## Koncert i orkestrës kineze të flautit, Klosi: Falënderim për "Prestige Resort"

Ministri i Turizmit: Ambient i bukur e festiv, mikpritje e presidentit të "Hysenbelliu Group"

Qindra të ftuar kanë mbushur mbrëmë resortin "Prestige" në Golem ku performoi orkestra kineze e flautit të bambusë e përbërë nga muzikantët më të rinj të Kinës. Orkestra ndodhet në Shqipëri si pjesë e turit në Europën Lindore dhe atë Qendrore dhe interpretoi muzikën instrumentale të bazuar në kulturën kineze të përshtatur ...

Në faqen 12

FLET INXHINIERI

### Arben Dervishaj: Shteti, duhet fond për parandalimin e shembjes së urave

Në faqen 7

REAGOJNE BASHKITE

### Taksa e ndërtesës me faturat e dritave, OSHEE mban 4% komision

Në faqen 6

RRUGA FIER-VLORE

### Aksidenti i rëndë, vdes gruaja gjashtë muajshe shtatzënë, plagosen 5 të tjerë

Në faqen 4

PERPLASJA




### Balla: E njoh Begon, po s'ka mburojë nga unë. Paloka: Dorëhiqu, ke lidhje me trafikantë

Në faqen 3

Reportazh/ Pelegrinazh i madh botëror në tempullin mitik të lashtë botëror

## Tomori, kryemali i historisë së gjenezës shqiptare

*Kremtimet e festës së bektashinjve, merr pjesë edhe presidenti Meta*

Nga FERDINAND SAMARXHI

Ka ditë që rrugët që gjarpërojnë dhe të çojnë në malin e Tomorit, në Teqenë e Abaz Aliut, në majën e tij Çukë ku dikur ngrihej madhështor tempulli më i lashtë i botës, i Dodonës pellazgjike, Orakull i Zeusit





të kujtojnë ardhjen e qindra e qindra pelegrinëve që vinin nga të gjithë anët e botës përtej kufijve të kohëve të Ilirisë së Veriut e të tjera përreth saj. Tomori ngjason këto ditë me një qytezë të ngritur rishtas, në faqe mali, korijesh ...

Në faqet 10-11

SUMMER PAGES

### DJ Flor Bana: Me Stresin jemi miq, ja kur do të bëjmë një bashkëpunim

Suplement

# KRIMINALITETI
## PERPLASJA

PD: Prokuroria dhe policia standard të dyfishtë për mikun trafikant droge të Taulantit

# Paloka-Ballës: Jep dorëheqjen ke lidhje me trafikantë

## *"Kreu i Grupit të PS-së gënjeu për Çyrbjen"*



Valentina Madani

Nënkryetari i PD-së Edi Paloka hodhi dje akuza të ashpra ndaj socialistit Taulant Balla për lidhje me trafikantët e drogës.

Paloka u shpreh se Balla ka njohje dhe lidhje familjare me një nga anëtarët më të rrezikshëm të bandës së Lushnjës, Edmond Bego.

Paloka u shpreh se Balla nuk duhet të sfidonte PD-në po duhet të japë llogari në prokurori për lidhjet e tij me bandën e drogës. Në çdo vend normal, një rrëfim i tillë për miqësi familjare me botën e krimit do të pasonte me dorëheqjen nga çdo funksion politik. Në Shqipëri ky standard funksionon me shkarkim nga detyra për gjyqtarët, prokurorët dhe policët. Por nuk funksionon për Edi Ramën, Fatmir Xhafajn dhe Taulant Ballën", theksoi nënkryetari i PD-së. Paloka denoncoi se Balla përdori fëmijët për mburojë politike, dhe pyeti sërish se çfarë e lidh deputetin e PS-së me Edmond Begon. "Balla nuk i është përgjigjur pyetjes se çfarë e lidh atë me trafikantin. Balla gënjeu kur tha se miqësia me Begon nuk i ka dhënë trafikantit mburojë politike. Bego është anëtar i bandës së Aldo Bares, trafikant droge dhe sot Balla nuk duhet të sfidonte PD-në, por prokurorinë dhe policinë për të zbatuar ligjin dhe të verifikonin pasurinë e mikut të tij trafikant",-deklaroi z.Paloka. Përmes një deklarate për mediat, Paloka tha se Taulant Balla pas deklaratës duhet të kishte dhënë menjëherë dorëheqjen, por sipas tij ky standard në Shqipëri funksionon vetëm për prokurorë, gjyqtarë dhe policë, jo për qeveritarët. Ndërkohë Paloka shtoi se Balla gënjeu sërish sot dhe bëri gabim që sfidoi PD-në. Sipas tij Balla duhet të kishte sfiduar policinë dhe prokurorinë ku t'i kërkonte që të hetonin pasurinë e mikut të tij trafikant Edmond Bego. "Taulant Balla gënjeu publikisht, kur tha se miqësia me Edmond Begon nuk i ka dhënë trafikantit të drogës mburojë politike, por nuk i dha përgjigje pyetjes: Pse aksioni qeveritar "Forca e ligjit", i cili verifikon ligjshmërinë e pasurisë së trafikantëve të drogës, nuk ka vepruar ndaj mikut të tij Mondi Bego. Është gënjeshtër e pacipë deklarata e Taulant Ballës se miku i tij me 5 emra ishte një njeri i zakonshëm dhe po përdoret nga PD për të hedhur baltë mbi të për qëllime politike. Edmond Bego, alias Manoli Bego, alias Mond Bega, alias Saimir Sina, alias Saimir Gjatari është anëtar i bandës së Aldo Bares, trafikant i jashtëzakonshëm droge, i dënuar me 21 vite burgim në Itali. ", theksoi z.Paloka. Për sa i përket shpjegimit për Jurgis Çyrbjen, anëtarin e bandës tjetër, asaj të Emiljano Shullazit, sipas Palokës, i mjeri Taulant Balla gënjeu trashë. "Prokuroria nuk mund të japë zyrtarisht, siç tha Balla, asnjë informacion për persona nën hetim. Sot prokuroria ka rastin të sakrifikojë diçka nga përkushtimi politik dhe të japë përgjigje, nëse e ka informuar apo jo Taulant Ballën për Jurgis Çyrbjen. Heshtja e prokurorisë, siç ka vepruar gjithë këto ditë, veçse konfirmon faktin se ajo nuk i shërben të vërtetës, por pushtetit të Edi Ramës dhe krimit të organizuar të lidhur me të",-theksoi z.Paloka.

**AKUZA**
"Në çdo vend normal, një rrëfim i tillë për miqësi familjare me botën e krimit do të pasonte me dorëheqjen nga çdo funksion politik. Në Shqipëri ky standard funksionon me shkarki nga detyra për gjyqtarët, prokurorët dhe policët",-theksoi z.Paloka.





# Urimi

**SALI BERISHA**
Ish-Kryeministri Sali Berisha uroi besimtarët myslimanë dhe gjithë shqiptarët, për festën e Kurban Bajramit. Në një postim në rrjetet sociale, të shoqëruar me një foto të tij dhe të bashkëshortes, Berisha e konsideroi Kurban Bajramin, si ditën e mëshirës dhe sakrificës për të Madhin Zot, veten, familjen, vendin dhe kombin e tyre.

## Rama uron nga kantieret e punës së xhamive

# Meta: Tri mesazhet e Kurban Bajramit, Basha: Me besimin te Zoti

Kreu i shtetit, Ilir Meta u bë dje pjesë e urimeve pranë Komunitetit Mysliman Shqiptar. Presidenti deklaroi se janë tri mesazhet që duhen nxjerrë nga kjo festë, mesazhi i solidaritetit, bashkëpunimit dhe vëmendjes për ata që kanë nevojë. "Mesazhi i solidaritetit, bashkëpunimit, vëmendjes sidomos për ata që kanë më shumë nevojë për t'u përfshirë, përkrahur janë tri mesazhet që na sjell kjo ditë mjaft e rëndësishme e besimit islam. Kjo është një ditë që dëshmon bashkëjetesën tonë të shkëlqyer ndërfetare",- tha ai. Presidenti i Republikës, Ilir Meta zhvilloi dje paradite një vizitë në Selinë e Bashkësisë Myslimane Shqiptare me rastin e Festës së Kurban Bajramit, ku u prit nga Kryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar, Haxhi Skënder Bruçaj. Kryeministri i vendit, Edi Rama i uroi besimtarëve myslimanë festën e Kurban Bajramit. Me anë të një videoje në 'Facebook', Rama tregon pamje nga kantieret e punës për rimëkëmbjen e xhamive në vend. Në postimin e tij, ai shkruan se xhamitë janë pjesë e thesarit tonë të trashëgimisë historike e kulturore. "Mirëmëngjesi, dhe me këto pamje nga kantieret e shumta të punës për rimëkëmbjen e xhamive në mbarë vendin, që janë pjesë e thesarit tonë të trashëgimisë historike e kulturore, ju uroj të gjithë besimtarëve myslimanë. GËZUAR KURBAN BAJRAMIN",-shkruan Rama. Kurse kreu i opozitës Lulzim Basha deklaroi se mesazhi i kësaj feste dëshmon se nuk ka sprovë që nuk kalohet me besim tek Zoti dhe dashuri për atdheun, familjen dhe njëri-tjetrin. Në mesazhin e tij për besimtarët Basha shkruan se lutjet e tij shkojnë për të pamundurit të braktisurit dhe nëpërkëmburit. "Në Festën e Flijimit që kremton mposhtjen e egos dhe forcën e besimit në Zot, mendimet dhe lutjet e mija shkojnë në veçanti tek të pamundurit, të braktisurit, dhe të nëpërkëmburit. Mesazhi i kësaj feste dëshmon se nuk ka sprovë që nuk kalohet me besim tek Zoti dhe dashuri për atdheun, familjen dhe njëri-tjetrin. Zoti e bekoftë Shqipërinë dhe shqiptarët kudo ku janë!", shprehet z.Basha.



**Olta Xhaçka**
Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka takoi dje në qarkun e Dibrës, familjet e prekura nga tërmeti i rënë pak ditë më parë. Xhaçka u takua me familjet në fshatin Vinjoll dhe në Dukagjin, ku ishte dhe epiqendra e tërmetit. Nga zonat e prekura nga tërmeti Xhaçka uroi besimtarët myslimanë për festën e Kurban Bajramit.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Dossier:** Iv Kaloçi, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli,
***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI. ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416**, *Marketingu*:** Cel:0682074415***-email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



Kuvendi nis punimet me 3 shtator, PS apel opozitës: Të votojmë Magjistraturën

# Balla: Begon e njoh familjarisht, por nuk ka mburojë politike

## "Çyrbja, bëra verifikimet, asnjë hetim ndaj tij"

Valentina Madani

Taulant Balla nuk e mohon se e njeh, madje ka njohje familjare me Edmond Begon, ish-anëtarin e bandës së Lushnjës. Por hedh poshtë akuzat e demokratëve se personit në fjalë, i arrestuar pak ditë më parë nga policia greke pas një urdhri ndërkombëtar të lëshuar nga drejtësia italiane që e ka dënuar me 21 vite burg për trafik droge dhe përfshirje në grup kriminal, të ketë përfituar mburojë politike. "Personin në fjalë sigurisht që e njoh, njoh bashkëshorten e tij dhe fëmijët e shkëlqyer, nxënës shembullorë moshatarë me tim bir. Dua t'ju them me garanci të plotë se kurrë nuk i është ofruar një mburojë dhe përgjigjen e ka dhënë shteti shqiptar. Që shumë shqiptarë nëpër kufij të ndryshëm të BE vendosen në proces verifikimi të së shkuarës së tyre është një proces normal dhe janë të shumtë ata që e dinë", - deklaroi z.Balla. Ai shtoi më tej se: "Për mua në këtë proces është e rëndësishme që të hiqet dorë për hedhje baltë në dëm të krahut tjetër. Në fund të kësaj do të kemi pjesë të serisë Babale 3, sepse personi nuk ka qenë në kërkim dhe nuk është në kërkim ndërkombëtar nga askush dhe pas verifikimit, pyeteni personin vetë nëse ka pasur ndonjëherë nevojë për mburojë politike. Këtu e konsideroj të mbyllur këtë çështje". Akuzat e opozitës i hedh poshtë dhe për deputetin e grupit të tij parlamentar, Jurgis Çyrbja për të cilin në media u publikuan përgjigje me pjesëtarë të bandës së Emiliano Shullazit. I pyetur për përgjimet që i janë bërë deputetit socialist Jurgis Çyrbjes me anëtarin e një bande kriminale, Balla u shpreh se ky lajm qarkullon prej një viti. "Ju e dini më mirë se unë se ky lajm qarkullon prej një viti. Unë si kryetar i Grupit Parlamentar kam bërë verifikimet, kam marrë informacionet nga organet ligjzbatuese, deputeti në fjalë nuk ka në ngarkim të tij asnjë hetim apo procedim penal për çështjen në fjalë", deklaroi z.Balla. Ai i bëri sërish thirrje opozitës që të japë votën pro dispozitës për Shkollën e Magjistraturës. Kërkesa e zyrtarit socialist u bë gjatë konferencës me dy deputetët gjermanë. Thirrja e Ballës duket se vjen para nisjes së sesionit të ri parlamentar më 3 shtator në ora 18:00. "Kuvendi nis më 3 shtator dhe unë do të doja të ribëja apelin kundrejt opozitës që në seancën e parë apo të 3 shtatorit që mblidhet në orën 18:00 të kishim mundësi të votonin rivendosjen në afat të një dispozite tranzitore që ka të bëjë me Shkollën e Magjistraturës",-deklaroi Balla. Në takimin me Josip Juratovic dhe Martin Roseman Balla tha se u diskutua për integrimin dhe u analizua puna e bërë gjatë muajve korrik dhe gusht për procesin screeing. Ndërsa gjermani Juratovic garantoi mbështetjen e Gjermanisë në procesin e integrimit, por kishte një lutje për të gjithë shqiptarët. "Na ndihmoni që t'ju ndihmojmë! Ecuria pozitive e reformës në drejtësi, është një argument pozitiv për Gjermaninë dhe për vendet e tjera të BE-së. Shqipëria dhe rajoni janë një oborr i brendshëm i Europës, në këtë këndvështrim janë pjesë e Europës. Gjermania është e angazhuar për marrjen e vendimeve pozitive për Shqipërinë dhe rajonin", u shpreh Josip Juratovic. Gjithashtu, Balla kritikoi Gjermaninë për vonesat në ambasada për pajisjen me viza për të gjithë shqiptarët profesionistë që kërkojnë të punojnë në Gjermani. Ndërsa deputeti i Bundestagut premtoi që do të rishikohen procedurat për lehtësimin e vizave të punës. Balla theksoi: "Të vlerësohet mundësia e ndryshimit të procesit të marrjes së vizave të punës po të kemi parasysh që ky proces aktualisht zgjat edhe me muaj". Kurse Josip Juratovic deklaroi: "Kemi kritika nga shteti shqiptar për vonesat me vizat e punës, por ne do të shikojmë për lehtësimin e procedurave, sepse kjo vonesë nuk dëmton vetëm punëkërkuesit shqiptarë, por edhe biznesin gjerman."



**PETRIT VASILI**

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI, Petrit Vasili, reagoi me një poezi të Bertolt Brecht për të përshkruar aktualitetin politik në Shqipëri. Vasili mbi poezi shkruan vetëm një fjali për ta lidhur me kontekstin: Shqipëria peng dhe viktimë e analfabetëve politikë....

### Të rinjtë e LSI-së "ndezin" Jalën

## Gjosha: Integrimi në BE, peng i lidhjeve të politikës me krimin

Të rinjtë e LSI, prej dy ditësh ndodhen në Jalë, ku vijojnë traditën e tyre. Përveç të rinjve pjesë e këtij kampingu janë bërë edhe deputetët e LSI-së, të cilët shkëmbejnë ide si dhe japin këshilla për të rinjtë shqiptarë se si ata duhet të punojnë më shumë për vete dhe për vendin e tyre. Në fjalën e saj para të rinjve deputetja Klajda Gjosha tha se Shqipëria vijon të nge-



let peng i krimit dhe korrupsionit. 'Shqipëria vazhdon të mbetet peng i çeljes së negociatave si pasojë e lidhjes së politikës me krimin. Dhe kjo është një pikë shumë delikate, sepse nuk ka gjë më të tmerrshme sesa politika e lidhur me krimin të drejtojë qytetarët dhe rininë shqiptare. Gjithashtu, ajo theksoi se LSI është në opozitë pikërisht sepse nuk mund të pajtohet me këtë fakt dhe se për LSI, rrugëtimi i Shqipërisë në BE është i panegociueshëm',-u shpreh Gjosha.

### "'Babalekracia" paska thënë të vërtetën!"

## Manjani: Shoku Taulant bëri mirë, miqësitë familjare nuk mohohen

Ish-ministri Ylli Manjani ka reaguar në lidhje me deklaratat e Taulant Ballës për Edmond Begon. Në një status në FB, Manjani shprehet se Balla bëri mirë që pranoi miqësinë, por nuk duhet të hidhte akuza mbi opozitën. "Shoku Taulant bëri mirë që e pranoi njohjen dhe miqësinë me të arrestuarin. Ashtu është miqësitë familjare nuk mund të mohohen, aq më tepër në ditë të vështira. Po përse duhet të hidhte lumin me m... ndaj opozitës një ditë më parë?! Ja që "Babalekracia" paska thënë të vërtetën! Tani, me ç'fytyrë kërkon bashkëpunim me opozitën "Babalokratike" shoku Taulant?! I preu barku për Shkollën e Magjistraturës, apo për pranimet e reja në këtë shkollë? Effff, na e shpifën!",- shkruan ish-ministri i drejtësisë Ylli Manjani.

### "Në shtator do të fryjë erë e fortë"

## Ndoka, Ramës: Dordolec, largohu me vapën e gushtit

Kreu i PDK-së, Nard Ndoka, e cilësoi kryeministrin shqiptar Edi Rama dhe mënyrën se si po qeveris, një shtet dordolecësh. Ndoka shprehet se ashtu si dordoleci i vendosur në mes të arës për të trembur shpendët, edhe Rama është vënë në mes të shtetit për të trembur dhe burgosur qytetarët. Ndoka i bëri thirrje Ramës që të largohet vetë me vapën e gushtin, pasi në shtator era e fortë do ta fluturojë atë si një dordolec, duke pasur parasysh protestat e forta opozitare që pritet të ndodhin. "Shtet ligjor, apo shtet dordolecësh?! Dordoleci vihet kryesisht në kopshte e ara të mbjella për të trembur shpendët. E prapë dordoleci kryeministër, flet për shtet ligjor! Dështove Edi Rama; premtove shtet ligjor, por ndërtove shtet dordolecësh! Largohu së bashku me vapën në gusht, se në shtator do fryjë erë e fortë për ty e dordolecët që ti kujton se do të trembësh të tjerët. Koha jote mbaroi, kuptoje kaqëgjë, se pastaj ti e din; dordoleci shkulet krejt lehtë!",-shkruan Ndoka në 'Fb'.

### Dhimbje në familje, të afërmit: Ishte djalë i mrekullueshëm

# Humbi jetën në tragjedinë e Xhenovas, përcillet në banesën e fundit 32-vjeçari Admir Bokrina

**SHKODËR** - Admir Bokrina, 32 vjeçari nga Shkodra, i cili humbi jetën pak ditë më parë në tragjedinë e Xhenovas, pas shembjes të urës Morandi është përcjellë dje për në banesën e fundit. Të riut nga Oblika iu dha lamtumira e fundit në fshatin e tij, aty ku i lind dhe u bë 12 vjeç para se të emigronte drejt Italisë. Përveçse familjarëve, të afërmeve, miqve dhe të njohurve, në ceremoninë mortore morën pjesë edhe shumë qytetarë të Shkodrës. Në momentin kur arkivoli me trupin e pajetë doli nga shtëpia, të gjithë kanë përjetuar një dhimbje të madhe. Kortezhi mortor u ndal fillimisht pak metra nga rrugica ku banon familja Bokrina për të kryer ritet fetare. Më pas trupi i pajetë u përcjell për t'u prehur përjetësisht tek varrezat e fshatit. Ruzhdi Poda, mësuesi i babait të Admir Bokrinës tha me lot në sy se familja Bokrina duhet të ndjehet krenare, sepse djali i tyre humbi jetën duke shkuar në punë dhe jo duke u marrë me punë të papëlqyeshme në Itali.



"Është një dhimbje shumë e thellë për të gjithë familjarët, por edhe për të gjithë ne të tjerët. Jemi shumë të prekur nga ajo çfarë ka ndodhur. Admir Bokrina ishte një djalë i mrekullueshëm. Ngjarja është shumë e hidhur, por nga ana tjetër familja duhet që të ndjehen krenar sepse djali i tyre humbi jetën duke shkuar në punë dhe jo duke u marrë me banda, me drogë apo me vrasje e gjëra të tjera të papëlqyeshme. Djem të tillë rrit zona, bija të tilla rrit Shqipëria, të cilët shkojnë rrugëve të botës për të punuar dhe për të na bërë krenarë. Unë babait të Admirit i kam dhënë mësim në shkollë. Janë një familje me histori, sepse gjyshi i tyre ka marrë pjesë në luftën e 1912-1913-ës në malin e Taraboshit në Shkodër. Ndjehemi shumë keq që Admiri nuk jeton më, dhe Zoti i dhëntë forcë familjes. I shprehim ngushëllimet tona", u shpreh Poda. Ndërsa, Muhamet Çeka, një tjetër banor i zonës, i cili e njeh mirë familjen Bokrina dhe ka punuar për shumë kohë me viktimën në Itali, por edhe me babain e tij Asllan Bokrinën pohoi se ndjen keqardhje të madhe për atë që ndodhi, ndërsa tregoi se 32 vjeçari ishte një djalë tejet punëtor. Ndërkaq, babai i viktimës Asllan Bokrina dha vetëm një mesazh të shkurtër: "Faleminderit të gjithëve, ju falënderoj shumë!".



Ceremonia e varrimit të Admir Bokrinës

### Aksidenti, drejtuesi i një mjeti: Rashë në kanal se u tremba nga sirenat e policisë

# Përplasen dy automjete në Levan, vdes gruaja shtatzënë 6-muajshe

## *Shkak parakalimi i gabuar, plagoset rëndë vajza e viktimës si dhe 4 persona të tjerë*

**FIER**

Një aksident i rëndë automobilistik ndodhi paraditen e djeshme në aksin rrugor Fier-Levan. Nga përplasja e dy automjeteve humbi jetën një grua shtatzënë 6-muajshe. Bëhet fjalë për 27-vjeçaren Majlinda Troka. Ndërkohë, në këtë aksident u plagos vajza e saj 7-vjeçe dhe vjehrri si dhe tre persona të tjerë që ndodheshin në automjetin tjetër. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Fierit bënë me dije se ngjarja u shënua në ora 11:30 në vendin e quajtur "Liqeni". Sipas bluve, viktima po udhëtonte në drejtim të Fierit me makinën tip "Audi". Ndërsa, makina tjetër tip "Benz" po lëvizte nga Fieri për në drejtim të Vlorës. si Pasojë e përplasjes së fortë, të dy mjetet kanë dalë nga rruga. Paraprakisht dyshohet se 'Benzi' ka hyrë në parakalim të gabuar duke përplasur 'Audin' që drejtohej nga vjehrri i viktimës, Astrit Troka. Edhe pse ky i fundit ka ulur shpejtësinë përplasja ka qenë fatale duke i marrë jetën gruas shtatzënë si dhe ka plagosur rëndë fëmijën e saj. 58-vjeçari Troka dhe fëmija u dërguan në spitalin e Fierit ku ndodhen nën kujdesin e mjekëve dhe jashtë rrezikut për jetën. Mësohet se edhe tre personat e plagosur në automjetin tjetër paraqiten jashtë rrezikut për jetën. Menjëherë pas aksidentit, policia ka nisur hetimet. Grupi hetimor do të kryejë një ekspertizë përfundimtare dhe vetëm pas saj do përcaktohet shkaku i këtij aksidenti të rëndë. Ndërkaq, një shofer i quajtur Vangjel Prifti duket se është traumatizuar më shumë nga kjo ngjarje, jo për shkak të aksidentit, por të policisë. Në një rrëfim për "News24" dhe "Gazeta Shqiptare", ai tregoi i indinjuar se ishte duke lëvizur me makinën e tij me targa AA289KP kur ka dalë nga rruga dhe ka përfunduar në kanal për shkak të sirenave të policisë. Gjithashtu, Prifti pohoi se ishte rreth 2 km larg nga vendi ku ndodhi aksidenti, kur makina e policisë me sirenat që ishte duke kaluar i është afruar afër dhe ai i trembur ka dalë nga rruga dhe ka përfunduar në kanal. "Nuk e mora vesh nëse në krahun tim ishte një makinë e policisë apo ambulancë. Andej nga krahu tjetër, rruga ishte e bllokuar. Ishte një makinë të madhe si ato të policisë, por nuk e përshkruaj dot. Ishte furgon i madh me sirena te ndezura. Me sirena është edhe ambulanca, por ajo ishte makinë me ngjyrë blu të errët si e policisë", tha drejtuesi i mjetit me targa AA289KP, Vangjel Prifti.



Aksidenti i djeshëm në Fier



Shoferi Vangjel Prifti duke folur për GSH

**PERSONAT E AKSIDENTUAR**

**VIKTIMA:**

Majlinda Troka 27 vjeç

**TË PLAGOSURIT:**

1.Klaudia Troka 44 vjeç nga fshati Martinë

2.Astrit Troka 58 vjeç nga fshati Martinë

3.Lukrecia Troka 7 vjeç nga fshati Martinë

4.Laurent Troka 31 vjeç nga fshati Nuselalë

5. Renato Troka, 6 vjeç nga fshati Nuselalë

**LIBRAZHD**

Një udhëtim që mund të kishte përfunduar në tragjedi. Një autobus me rreth 40 persona, shumica të afërm mes tyre është aksidentuar pasditen e se hënës në vendin e quajtur Shkalla e Lubikut në Librazhd. Mësohet se të gjithë personat kishin qenë në një varrim në një fshat të Librazhdit dhe po ktheheshin për në Durrës. Autobusi ka rrezikuar të dalë nga rruga dhe gjatë manovrimit është përplasur me një shkëmb. Ndërkaq, burime zyrtare nga policia lokale thanë se autobusi nuk ka pasur pasagjerë në momentin e daljes nga rruga.

### Masakroi me thikë kushëririn, Anglia shpall në kërkim Granit Shehun

**ANGLI** - Një 34-vjeçar shqiptar është shpallur në kërkim nga autoritetet e Britanisë së Madhe. Mediat britanike shkruajnë se bëhet fjalë për Granit Shehun, i cili është një person i kërkuar në Shqipëri për vrasje të ndodhur tre vite më parë. Ngjarja për të cilën ai akuzohet u shënua më 16 shtator të vitit 2015, ku pas një sherri Graniti masakroi me thikë djalin e xhaxhait, Milazim Shehu. Viktima u godit 12 herë tek dera e shtëpisë duke mbetur i vdekur në vend. Pas kryerjes së hetimeve, prokuroria bëri me dije se ngjarja e rëndë mori shkas nga një pretendim i autorit të krimit Granit Shehu se vajza e të ndjerit, i kishte vjedhur në banesë një sasi prej 12 mijë lekësh të rinj. Një pretendim i tillë, nuk është pranuar nga Milazim Shehu, ndërsa të dy ata janë konfliktuar mes tyre. Pas kësaj ngjarjeje, dyshohet se Granit Shehu është fshehur në Britani. Ai njihet për lidhjet në qytete si: Londra, Eastbournein, Leedonin dhe Midlandsin Perëndimor, por nuk dihet se ku fshihet me saktësi. I riu shqiptar përshkruhet si i bardhë, me flokë kafe të shkurtër. Për shkak të krimit të rëndë, për të cilin akuzohet 34-vjeçari, autoritetet kanë njoftuar që qytetarët britanikë të raportojnë nëse e shohin, madje t'i qëndrojnë sa më larg nëse kanë lidhje me të. Të gjithë ata që kanë informacion për vendndodhjen e tij mund të telefonojnë në numrat 0207 230 3191 dhe 0800 555 111.

### Komunikimet telefonike, Krimet e Rënda autorizuan përgjimin më 7 janar 2016

# Dosja "Shullazi", zbardhet biseda e plotë mes Jurgis Çyrbjas dhe Gilmando Danit

## Ja si u informuan anëtarët e bandës për hetimet e prokurorisë

Ina Allkanjari

Pak ditë pas publikimit të përgjimeve të bisedave telefonike të zhvilluara mes deputetit të Partisë Socialiste, Jurgis Çyrbja me një nga anëtarët e bandës së Emiljano Shullazit, të tjera detaje dalin në dritë. Ndërkohë që gjyqi ndaj Emiljano Shullazit dhe miqve të tij është në fazën e konkluzioneve përfundimtare, "Gazeta Shqiptare" zbardh mënyrën se si ra në rrjetën e përgjimit ish-zyrtari i lartë i Hipotekës në Durrës dhe bisedat që zhvilloi me të pandehurin Gilmando Dani. Referuar dokumenteve rezulton se me vendimin nr.10 të datës 7 janar 2016, Gjykata për Krime të Rënda autorizoi përgjimin e disa numrave telefonike, njëri prej të cilëve i përkiste Gilmando Danit, pasi kishte dyshime se ishte i përfshirë në aktivitet kriminal në fushën e gjobëvënies. Dy prej bisedave të përgjuara rezulton se janë zhvilluar mes të pandehurit Dani dhe deputetit Çyrbja. Bisedat janë zhvilluar në muajin shkurt dhe janë transkriptuar në procesverbalin e datës 27 të po të njëjtit muaj me numrat rendor 409 dhe 411. Bisedat janë zhvilluar brenda së njëjtës dite me diference të shkurtër kohore nga njëratjetra. Një njërën prej tyre Dani e pyet Çyrbjan, nëse kishte ndonjë gjë serioze andej nga puna e tij, pra në Hipotekën e Durrësit, ku ai mbante postin e kryeregjistruesit. Referuar dosjes hetimore rezultoi se menjëherë sapo një oficer i policisë gjyqësore shkoi në zyrat e Hipotekës në Durrës për të sekuestruar praktikën e regjistrimit të ish-hotel Vollgës, Çyrbja telefonon Gilmando Danin, i konsideruar si krahu i djathtë i Shullazit. Ligjvënësi e informon atë, se prokuroria ishte vënë në lëvizje dhe shprehte shqetësim për këtë fakt. Po atë ditë, prokurorët e ftuan Çyrbjan, të jepte shpjegime në cilësinë e personit që kishte dijeni për rrethanat e hetimit. Pasi mbaron rrëfimin e tij, pa kapërcyer rrethimin e godinës së xhamtë, ligjvënësi telefonon sërish Gilmando Danin dhe i kërkon të takohen. Nga ai moment deputeti dhe i dyshuari nuk rezultoi të kenë folur më në telefon. Pak muaj më vonë Çyrbja u ballafaqua në sallën e gjyqit me Shullazin dhe të pandehurit e tjerë duke dhënë dëshminë e tij. Ai foli asokohe edhe për një takim që kishte pasur me Emiljano Shullazin, për çështjen e ish-hotel Vollgës, por nuk pranoi të kishte pasur komunikime me miqtë e tij përmes telefonit, ku i informonte për gjithë sa ndodhte. Ndërkohë përgjimet ndodhen në prokurorinë për Krime të Rënda, e cila në fillim të shtatorit pritet të shpallë prezencën e saj për Emiljano Shullazin dhe të pandehurit e tjerë. Kujtojmë se pas zbulimit të bisedave mes Danit dhe Çyrbjas dhe publikimit të tyre, deputeti i Partisë Socialiste reagoi menjëherë në rrjetin e tij social 'Facebook', duke pretenduar se këtë çështje e ka sqaruar në prokurori, por pa mohuar faktin që kishte biseduar në telefon me Gilmado Danin.

"Jam i detyruar të jap një shpjegim publik si detyrim për zgjedhësit e mi mbi atë çfarë në media është transmetuar dhe më pas është keqpërdorur si gjithmonë nga opozita pa ekip dhe pa lidership.

Gjithçka pretendohet sot i kam sqaruar në prokurori dhe në dëshminë time përpara organeve të drejtësisë më shumë se një vit më parë.

Dua të informoj publikun se kjo është një çështje e hetuar nga prokuroria ku unë kam dhënë të gjithë informacionet dhe dëshmitë.

Ata që sponsorizojnë lajme vere, nuk do të arrijnë qëllimin për të dëmtuar imazhin tim dhe të grupit parlamentar ku kam nderin të bej pjesë, sikundërse nuk e arritën edhe para një viti me po të njëjtin lajm vere", u shpreh ish-zyrtari i lartë i Hipotekës në Durrës.

**AKUZAT NDAJ BANDËS "SHULLAZI"**

Prokuroria e akuzon bandën 'Shullazi' se duke vepruar si grup i strukturuar kriminal kanë shtrënguar me anën e kanosjes shtetasin Ylvi Beqja dhe ky i fundit i kaloi në pronësi Emiljano Shullazit një pjesë të ish-hotel "Vollga" në Durrës, si edhe shuma të konsiderueshme monetare. Sipas akuzës në janar 2016, të akuzuarit kanë shtrënguar për dhënie pasurie shtetasin Adriatik Kërçuku, i cili ishte pronar i një biznesi në Lushnjë. Dy muaj pas kërcënimeve ndaj këtij shtetasi, konkretisht në mars 2016, pjesëtarët e grupit, akuzohen se kanë vendosur dhe shpërthyer lëndë plasëse tritol në ambientet e biznesit të të dëmtuarit Adriatik Kërçuku. Në shkurt 2016, grupi akuzohet se kanë shtrënguar për dhënie pasurie shtetasin Jani Zaka, i cili posedonte pronë në Tiranë, ku akuzohen se i kanë vendosur lëndë shpërthyese tritol një garazhi në pronësi të tij, në shenjë kërcënimi për qëllime përfitimi të paligjshëm. Në prill 2016, të pandehurit akuzohen se kanë kanosur për shkak të detyrës shtetasit Dhori Kule dhe Mynyr Kone, pedagogë dhe drejtues në Universitetin e Tiranës, me qëllim që profesor Kone të largohej nga gara për Rektor në këtë Universitet. Konkretisht të pandehurit Emiljano Shullazi, Gilmando Dani, Blerim Shullazi, Endrit Qyqja, Endrit Zela akuzohen për veprat penale "Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë", "Shkatërrimi i pronës me eksploziv", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit", "Kanosje për shkak të detyrës", "Trafikimi i narkotikëve" dhe "Grupi i strukturuar kriminal". Të pandehurit Emiljano Shullazi, Gilmando Dani, Besmir Shullazi, Endrit Qyqja, Endrit Zela rrezikojnë dënime deri në 15 vite burg.



Deputeti i partisë socialiste Jurgis Çyrbja



Emiliano Shullazi dhe anëtarët e tjerë të bandës në gjykatë

**DIALOGU I ZHVILLUAR MES JURGIS ÇYRBJA DHE GILMANDO DANI**

**Dani**: O vlla ça bane?

**Çyrbja**: Mirë, ça ban ti?

**Dani**: Me ta ba një pyetje kshu kot, ore ka noj gja ku ke punu ti apo si?

**Çyrbja**: Ehe ehe

**Dani**: Noj gjë serioze?

**Çyrbja**: Jam rrugës, jam rrugës

**Dani**: E mirë ndonjë gjë serioze apo kshu?

**Çyrbja**: Emm, duket se po….

**PËRGJIMI**

Referuar dokumenteve rezulton se me vendimin nr.10 të datës 7 janar 2016, gjykata për Krime të Rënda autorizoi përgjimin e disa numrave telefonikë, njëri prej të cilëve i përkiste Gilmando Danit, pasi kishte dyshime se ishte i përfshirë në aktivitet kriminal në fushën e gjobëvënies.



### Gjendet i vdekur 29-vjeçari në Lezhë, policia: U mbyt në rezervuar

**LEZHE-** Një 29-vjecar është gjetur i vdekur mëngjesin e djeshëm në fshatin Krajen të Lezhës. Policia bën me dije se viktima është B.L., 29 vjeç. I riu u gjet pa shenja jete në një rezervuar uji pranë banesës së tij. Nga veprimet e para të policisë rezulton se vdekja e 29-vjeçarit ka ardhur nga mbytja në ujë. "Më datë 21.08.2018, rreth orës 06:30, në fshatin Krajen në Lezhë, në një rezervuar uji, afër banesës së tij, është gjetur i vdekur dhe pa shenja dhune, shtetasi B.L., 29 vjeç. Nga veprimet e kryera, dyshohet se vdekja ka ardhur nga mbytja në ujë. Materialet u referuan në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Lezhë, për ngjarje aksidentale"- thuhet në njoftimin e policisë.

### Kapet me 14 mijë euro në Kakavijë, policia greke ndalon shqiptarin

**KAKAVIJE** - Një shtetas shqiptar është arrestuar nga policia në doganën e Kakavijës. Ai u kap në tentativë për të hyrë në Shqipëri me 14 mijë euro të padeklaruara. Shqiptari u kap nga policia greke me valutë të fshehur. Bëhet me dije së pasi u gjobit me 25% të vlerës që iu gjet e pa deklaruar, shqiptari u la i lirë. Ndërkohë identiteti i tij nuk bëhet i ditur.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Zyra permbarimore "Best 2010"
SHPALLJE ANKANDI
**Më datë 17 shtator 2018 nga ora.08.00-ora.16.00** tek kjo zyrë përmbarimore do zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë nr.58/56, vol 17, fq 3 të ndodhur në L.13, ZK 8518, Plazh, Durrës. Trualli që ka sipërfaqen prej 600 m² kufizohet sipas një marrëveshje sipërmarrje.
Prona është e vëllezërve, z.Arben e z.Shkëlqim Riza Brameta
Çmimi fillestar me të cilin hapet ankandi do të jetë 48735000 lek.
Çmimi mund të llogaritet edhe në euro sipas kursit të këmbimit ditor.
Ofertuesit duhet të kenë depozituar në llogarinë e zyrës përmbarimore 10% të çmimit fillestar.
**Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-6000**
**E-mail: best.2010@permbarues.al, web: www.permbarues.al**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Zyra permbarimore "Best 2010"
SHPALLJE ANKANDI
**Më datë 17 shtator 2018 nga ora.08.00-ora.16.00** tek kjo zyrë përmbarimore do zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë nr.58/56, vol 17, fq 3 të ndodhur në L.13, ZK 8518, Plazh, Durrës. Trualli që ka sipërfaqen prej 600 m² kufizohet sipas një marrëveshje sipërmarrje.
Prona është e vëllezërve, z.Arben e z.Shkëlqim Riza Brameta
Çmimi fillestar me të cilin hapet ankandi do të jetë 48735000 lek.
Çmimi mund të llogaritet edhe në euro sipas kursit të këmbimit ditor.
Ofertuesit duhet të kenë depozituar në llogarinë e zyrës përmbarimore 10% të çmimit fillestar.
**Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-6000**
**E-mail: best.2010@permbarues.al, web: www.permbarues.al**

### Bashkitë: Shkelje e ligjit, duhet ta caktojnë këshillat bashkiakë

Ornela Manjani

# Taksa e ndërtesës tek OSHEE, 4% komision

## *Taksa mbi shtëpitë, 10 kategoritë që përjashtohen*

Caktimi nga qeveria i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike si agjent për mbledhjen e taksës së ndërtesës është ndërhyrje flagrante dhe e hapur ndaj pushtetit vendor". Ky është qëndrimi i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë pas projektvendimit të Këshillit të Ministrave, i cili autorizon pikërisht OSHEE-në për mbledhjen e kësaj takse. Sipas shoqatës, 'projektvendimi i paligjshëm i qeverisë parashikon që OSHEE të mbledhë taksën e ndërtesës kundrejt një komisioni prej 4% të shumës së mbledhur", çka është në kundërshtim të hapur me ligjin për vetëqeverisjen vendore dhe me ligjin për sistemin e taksave vendore, ku thuhet shprehimisht se "është e drejta e bashkisë të përcaktojë mënyrën e mbledhjes së taksës, përfshirë zgjedhjen e agjentit fiskal dhe detyrimet e ndërsjella". Nga ana tjetër, Shoqata e Bashkive thekson se ndërhyrja e qeverisë me një agjent tatimor të varur prej saj është provuar si e dështuar, pasi në rastin kur Drejtoritë Rajonale Tatimore u caktuan nga qeveria për mbledhjen e një takse vendore si ajo e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin të biznesit të vogël, të ardhurat e bashkive u reduktuan ndjeshëm dhe sistemi i llogaritjes së parave të mbledhura, u fut në kaos. Nisur nga këto argumentime, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë kërkon tërheqjen e qeverisë nga nisma antiligjore, që cenon rëndë autonominë vendore dhe kërkon që të jenë bashkitë ato që do të vendosin sesi do të mblidhet taksa e ndërtesës. Për këtë arsye i është dërguar edhe një letër ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj ku i rekomandojnë që agjenti që do të bëjë mbledhjen e taksë të caktohet nga Këshillat Bashkiakë, ndërsa komisioni i mbledhjes së saj të caktohet mes palëve, duke mos përjashtuar mundësinë e përzgjedhjes së Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.



**KATEGORITË QË PËRJASHTOHEN**

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesën, shtëpinë, 10 kategori. Të përjashtuara nga detyrimi janë ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet; kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët; ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike; banesat sociale, objektet e kultit dhe ato që u shërbejnë klerikëve etj. Ndërkohë të gjitha ndërtesat e tjera do të taksohen mbi vlerën e tregut në tri shkallë. Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është: a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim; b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike; c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvillluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi. Këto janë ndryshimet në ligjin për taksat vendore, i cili hyn në fuqi në fillim të vitit të ardhshëm. Ligji është botuar dje në Fletoren Zyrtare dhe parashikon se taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.

**MBLEDHJA E TAKSËS**

Njësia e vetëqeverisjes vendore është autoriteti përgjegjës për administrimin e taksës mbi ndërtesat. Njësitë administrative kryejnë: a) mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve mbi ndërtesën për qëllime fiskale; b) përditësimin e të dhënave të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale); c) mbledhjen me forcë të detyrimeve të taksës mbi ndërtesën; ç) korrigjimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës, në rastet e saktësimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, çmimet e tregut etj.; d) shqyrtimin e ankimit administrativ të taksapaguesve. 2. Taksa mbi ndërtesën, sipas dispozitave të këtij ligji, mund të mblidhet nëpërmjet agjentëve të taksave, të cilët kanë shtrirje territoriale, sistem elektronik të bazës së të dhënave e të gjenerimit të detyrimeve dhe që autorizohen me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore. Këshilli i Ministrave përcakton edhe masën e përfitimit të agjentit të autorizuar, mbi të ardhurat e arkëtuara nga taksa e ndërtesave. 3. Të ardhurat e mbledhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme derdhen për llogari të buxhetit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, dhe përdoren në përputhje me ligjin "Për financat e vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

**SHKALLA E TAKSËS**

**Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:**

♦ 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;

♦ 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;

♦ 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

**Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:**

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

♦ pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;

♦ pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;

♦ ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;

♦ banesat sociale në pronësi të bashkive;

♦ pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;

♦ ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;

♦ strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";

♦ ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët;

♦ ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;

♦ ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore.".

## Tatimet: Si kryhet çregjistrimi i personave juridikë, që kryejnë veprimtari jofitimprurëse

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka dhënë informacion lidhur me çregjistrimin e personave juridikë, që kryejnë veprimtari jofitimprurëse. Por ato paralajmërojnë se çregjistrimi tatimor nuk eliminon detyrimet ekzistuese tatimore dhe nuk parandalon administratën tatimore të vlerësojë ose të mbledhë detyrimet tatimore. Organizatat jofitimprurëse, fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve, entet publike kombëtare e vendore, organizatat politike dhe organet e tjera të ngjashme me to, që kryejnë veprimtari të ndryshme, çregjistrohen sipas dispozitave të ligjit. Organizata jofitimprurëse që dëshiron të çregjistrohet, për çfarëdo arsye qoftë, paraprakisht është e detyruar që të paguajë të gjithë detyrimet tatimore të papaguara dhe të paraqesë bilancin e mbylljes së veprimtarisë ekonomike në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve ku është regjistruar. Kërkesa për çregjistrim paraqitet në gjykatën përkatëse, sipas procedurave ligjore përkatëse. Gjykata nga ana e saj, njofton Drejtorinë Rajonale të Tatimeve të juridiksionit përkatës, për regjistrimin e hapjes së procedurës se çregjistrimit. Drejtoria Rajonale e Tatimeve e juridiksionit përkatës, brenda 10 ditëve pune, nga marrja e njoftimit për fillimin e procedurave të çregjistrimit, kryen të gjithë verifikimet e duhura lidhur me situatën tatimore të organizatës jofitimprurëse që kërkon të çregjistrohet. Verifikimi përfshin të gjitha detyrimet tatimore të organizatës jofitimprurëse, detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, gjobat dhe kamatëvonesat eventuale të lidhura me këto detyrime. Drejtoria Rajonale e Tatimeve, përveç verifikimit të situatës tatimore të personit të tatueshëm, kur e gjykon të nevojshme, mund të ushtrojë, mbi bazë risku edhe një kontroll tatimor në mjediset ku organizata jofitimprurëse ushtron veprimtarinë e saj. Ky kontroll nuk mund të jetë më shumë sesa 30 ditë pune. Nëse, nga këto verifikime apo nga kontrolli në vend, rezulton se organizata jofitimprurëse ka detyrime të papaguara, gjoba dhe kamatëvonesa, apo deklarata tatimore të paparaqitura, për të cilat ka detyrimin ligjor të paraqitjes, Drejtoria Rajonale e Tatimeve duhet të paraqesë në gjykatë kundërshtimin me shkrim të saj për çregjistrimin e kësaj organizate jofitimprurëse. Në kundërshtimin e çregjistrimit të organizatës jofitimprurëse, të paraqitur në gjykatë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve të juridiksionit, tregohet shuma e detyrimeve tatimore të papaguara. Nëse, në kundërshtimin me shkrim, të paraqitur nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, nuk është prezantuar shuma e detyrimeve tatimore të papaguara të organizatës jofitimprurëse, gjykata e juridiksionit mund të kryej çregjistrimin e saj.



## MIRËMBAJTJA E URAVE
### INTERVISTA

Inxhinieri: Rikonstruksioni i shkollave, iu bëhet vetëm "manikyri", nuk shikohen kushtet

# Arben Dervishaj: Shteti të japë fonde për të parandaluar shembjen e urave

*"Nuk ka database për vlerësimin e gjendjes së objekteve"*

Voltiza Duro

Pas tragjedisë në Xhenova të Italisë, ku si pasojë e shembjes së urës humbën jetën 43 persona, vëmendja e specialistëve të fushës e instancave përkatëse është kthyer në vlerësimin e gjendjes së urave në Shqipëri. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Arben Dervishaj, inxhinier ndërtimi me një eksperiencë shumëvjeçare, tregon disa prej faktorëve kryesorë që ndikojnë në uljen e kapacitetit të strukturës së urave duke theksuar se duhet të kryhen studime dhe vlerësime të sakta mbi këto objekte. Më tej specialisti bën me dije se vendi ynë nuk ka probleme vetëm me urat, por edhe me ndërtesat e digat, por sipas tij fondet jepen kur ndodh ngjarja, dhe jo për të parandaluar ngjarje si ajo e Xhenovas. Dervishaj thotë se është i nevojshëm ndryshimi i legjislacionit nga qeveria, në mënyrë që të bëhet vlerësimi i kapacitetit të strukturës, veçanërisht në godinat e ndërtuara para viteve 2000; si dhe shton se oponenca duhet të mbajë përgjegjësi ligjore mbi projektet që kalohen, por në shumë raste edhe zëri i oponentit nuk është dëgjuar nga ana e organeve përkatëse. Për sa i përket shkollave, kopshteve e spitaleve specialisti thekson se në rastet kur ka pasur ndërhyrje në këto struktura është bërë vetëm "manikyri", pra lustra dhe nuk është parë nëse plotësohen kushtet.



**Pas shembjes së urës në Xhenova të Italisë, në vendin tonë fokusi është vënë mbi urat dhe sigurinë e tyre. A janë problematike këto objekte në Shqipëri?**

Vendi ynë ka një numër të caktuar të urave, të cilat janë ndërtuar në vite të ndryshme, në kohë të ndryshme e me norma të ndryshme. Nëse do i perifrazoja do të kishim objekte që janë ndërtuar nga viti 30'deri në vitet 50' ku për herë të parë u vendosën normat shqiptare; më tej është kategoria e objekteve të ndërtuara nga vitet 50'- 90' që janë ndërtuar me norma jo aq të sofistikuara, por me kontrolle e procese të rregullta. Gjithashtu, kemi dhe ura të ndërtuara pas viteve 90' të cilat janë projektuar me norma më të larta. Të gjitha këto objekte kanë problematikat e tyre.

**Mund të përmendni disa prej faktorëve kryesorë që ndikojnë në uljen e kapacitetit të strukturës së urave?**

Problematikat e urave në vendin tonë shkaktohen për disa arsye. Së pari, janë objekte të ndërtuara mbi bazën e normave të vjetra; së dyti, kanë probleme me mirëmbajtjen e tyre ( e bëhet fjalë jo vetëm për objektet nën përgjegjësinë e ARRSH-së, por edhe ato të komunave e bashkive të ndryshme). Gjithashtu, këto objekte mund të mbartin problematika pasi janë dëmtuar si rezultat i ndërhyrjeve të njerëzve, e këto mund të jenë goditje të ndryshme që kanë pësuar strukturat nga veprimet mekanike, si dhe uljen e kapacitetit si rezultat i kalimit të kamionëve mbi ngarkesën e përcaktuar. Por edhe njerëzit mund të kenë prishur pjesën e parmakëve, pra paraqesin një sërë problematikash e si pasojë kapaciteti i strukturës ulet.

**Sipas mendimit tuaj, a paraqitet alarmante situata? A ka një studim të mirëfilltë mbi studimin e gjendjes së këtyre objekteve?**

Problemi nuk është i atij niveli që ne të vejmë alarmin, por duhet të kujdesemi që të bëjmë vlerësime të sakta e të shikojmë se çfarë ndërhyrjesh duhen bërë dhe si duhen bërë. Para disa vitesh është bërë një studim nga NATO për të vlerësuar kapacitetin mbajtës të urave në vendin tonë, projekt ky ndërkombëtar. Gjithashtu, në vitin 2005 nisi një projekt që kishte të bënte me krijimin e një database, por që nuk u aktivizua. Ndërsa në 2010 është tentuar sërish, por ende mungon një studim i tillë.

> Problematikat e urave në vendin tonë shkaktohen për disa arsye. Së pari, janë objekte të ndërtuara mbi bazën e normave të vjetra; së dyti, kanë probleme me mirëmbajtjen e tyre ( e bëhet fjalë jo vetëm për objektet nën përgjegjësinë e ARRSH-së, por edhe ato të komunave e bashkive të ndryshme).

**Çfarë duhet bërë për të shmangur problematikat e urave në Shqipëri?**

Së pari, duhet të krijojmë database-in, të shikohet gjendja ekzistuese e urave, të bëhet një inventar i plotë dhe jo vetëm për Autoritetin Rrugor Shqiptar, por edhe për kategoritë që janë nën përgjegjësinë e komunave edhe bashkive. Ne kemi problematika edhe për ndërtesat, digat, por është e mira që shteti të japë fonde për të parandaluar. Fondet jepen kur ndodh ngjarja, dhe jo për të parandaluar ngjarje si ajo e Xhenovas. Nuk kërkon fonde të jashtëzakonshme, por vetëm impenjim nga ana e shtetit. Kështu duhet bërë vlerësimi i gjendjes së urave dhe më tej nëpërmjet database-it, do të përcaktohen se sa përqind e urave kanë nevojë për ndërhyrje emergjente dhe sa kanë nevojë që të hartohen programe për vitet e ardhshme. Ka dëmtime që i kemi bërë ne, dhe ka të tjera që shkaktohen nga shfrytëzimi i pakontrolluar i lumenjve që sjellin edhe shkatërrimin e urës, njësoj si në urën e Skraparit që kishin dalë themelet si rezultat i shfrytëzimit pa kontroll të lumit.

> **STRATEGJIA**
> Së pari, duhet të krijojmë database-in, të shikohet gjendja ekzistuese e urave, të bëhet një inventar i plotë dhe jo vetëm për Autoritetin Rrugor Shqiptar, por edhe për kategoritë që janë nën përgjegjësinë e komunave edhe bashkive. Ne kemi problematika edhe për ndërtesat, digat, por është e mira që shteti të japë fonde për të parandaluar. Fondet jepen kur ndodh ngjarja, dhe jo për të parandaluar ngjarje si ajo e Xhenovas.

**Cilat janë disa prej urave që kanë nevojë për ndërhyrje urgjente?**

Autoriteti Rrugor Shqiptar i ka përcaktuar kryesisht se cilat ura kombëtare kanë nevojë për ndërhyrje që janë 7 të tilla. Por mesa kam parë unë janë urat sekondare në rrugët dytësore dhe urat terciare të cilat kanë dëmtime si: heqje të shtresës mbrojtëse, apo fillim të procesit të korrodimit, janë dëmtuar fugat që lejojnë futjen e ujit. Të gjitha këto procese fillojnë e rrisin njëra-tjetrën, pra fillojnë fenomene që rritin masën e ndryshkut çka sjell dëmtimin e betonit. Vlen të theksoj se në urat terciare dhe sekondare është shumë më e pakontrolluar lëvizja e mjeteve. Në akset lokale sinjalistika lë për të dëshiruar, e ka filluar amortizimi. Nuk ka nevojë të bëhen ura të reja, ka ura që duhet të riparohen dhe riparimi nuk ka kosto të mëdha; si dhe ka ura që paraqesin një mungesë të kapacitetit. Urat llogariten për një jetëgjatësi të caktuar e një numër kalimesh të caktuara. Nëse ne kalojmë ngarkesa më të mëdha seç duhet, i ulim jetëgjatësinë urës. Pra, organet e shtetit dhe policisë duhet të jenë shumë rigorozë në respektimin e ngarkesave që kalojnë urën; duhet që ARRSH duhet të bëjë plotësimin e sinjalistikës aty ku mungon; si dhe vetë njerëzit nuk duhet të lejojnë dëmtimet në urë. Më tej duhet të fillojë të hartohet një program për rregullimin e urave sipas rrezikshmërisë që mbartin.

**Sa të mirëmbajtura janë urat në vendin tonë?**

Nuk ka pasur mirëmbajtje. Çdo strukturë, edhe një shtëpi, një rrugë, një urë, një ndërtesë ka nevojë për riparim pasi në të kundërt fillojnë dëmtimet.

**Si paraqitet gjendja infrastrukturore e shkollave, spitaleve apo kopshteve në Shqipëri? A ka godina të këtij lloji që kanë nevojë për ndërhyrje emergjente?**

Fati i mirë është që shkollat në Shqipëri janë godina të ulëta, 2-3 katëshe, të cilat karshi rrezikut sizmik nuk janë shumë të ekspozuara. Por duhet të fillojnë vlerësimet dhe riparimet. Por gjithmonë kur është ndërhyrë në këto struktura është bërë vetëm "manikyri" pra lustra dhe nuk është parë nëse plotësohen kushtet. Duhet të ndryshojë legjislacioni nga qeveria, në mënyrë që të bëhet vlerësimi i kapacitetit të strukturës, veçanërisht në godinat e ndërtuara para viteve 2000. Duhet të vihet në ligj që oponenca të mbajë përgjegjësi ligjore mbi projektet që kalohen. Madje në shumë raste edhe zëri i oponentit nuk është dëgjuar nga ana e organeve përkatëse. Por në Shqipëri vazhdon të ngelet po njësoj situata. Duhet bërë kujdes pasi në rastet e një tërmeti të fuqishëm, mund të gjendemi para një kolapsi. Shteti duhet t'i kushtojë më shumë rëndësi supervizionit, e madje ata që firmosin të përgjigjen penalisht në rast se ndodh një shembje.

Procedurat për certifikatën e pronësisë ndiqen nga Agjencia

Ornela Manjani

# ALUIZNI: 700 personat që kanë gati lejet e legalizimit

## *Lista me pronarët në qarkun e Tiranës*

ALUIZNI publikon listën me 700 pr onarët që kanë gati lejen e legalizimit në qarkun e Tiranës. Përfituesit duhet të tërheqin lejen e legalizimit dhe më pas presin që Agjencia e Legalizimeve të ndjekë procedurën për pajisjen e tyre me certifikatën e pronësisë. 'Gazeta Shqiptare' sjell listën e plotë me personat që kanë të printuara lejet. Personat duhet të drejtohen në drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana Rurale në Laprakë .

**TAPIA**

Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të aplikojnë për tapinë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesit të legalizimit, por gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat, për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin, nëpërmjet një kërkese me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirisht dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese edhe pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.



EMER ATESI MBIEMER
12_2161603 NJAZI BESIM BALLA
12_2165191 ZIJA SHAQIR ALUSHI
12_2203821 QEMAL HAQIF DODA,ARJAN QEMAL DODA
12_8151593 MERXHAN ISMEN DISHA
12_2201759 ALTIN,DRITAN LUAN KOKONAJ,MIRJANA LUAN BALLA
12_2201877 MUSA JONUS BALLA
12_2168755 SAIMIR NAMIK MEMA
12_8223350 SHYQYRI RIZA VOGLI
12_8227974 AJET BEKTASH TROKSI
12_8151153 FLOGERT KUJTIM KAZIU
12_2201593 SHYQYRI DAUT DALIPI
12_2202545 VEHAP MELAHIM SARAÇI
12_2168961 GEZIM NIKOLLE PJOLLA
12_8293667 PETRIT MUHAMET KORPA
12_8227324 ZARIFE HASAN ELEZAJ
12_3009648 NJAZI FEIM OSMANI,ZAMIR FEIM OSMANI
12_3010864 KRISTO NOVRUZ HAMITAJ
12_2165052 IDRIZ MEXHIT VLADI
12_3005708 ALI ARIF TOTA
12_8228567 MYFTAR FERID KUKLI
12_2205242 SOTIR BRAHIM PAPA
12_8151186 KUJTIM MUHARREM MICI
12_2155462 YLLI SEIT LAMI
12_2208160 HYSEN HASAN VLADI
12_8222817 TOMORR HAVZI QEJVANI
12_2206244 BARDHYL BAJRAM HYSA
12_2175651,12_3011677 SHKELZEN HALIL TOTA
12_2173826 ANDREA KUJTIM PINDERI
12_8229019 AGRON MUSTAFA SHEHU
12_2202920 GAZMEND SABRI ISHA
12_8141783 GENTIAN XHELAL KARAJ
12_2112752 NURI SEIT HAKA
12_2202422 ADEM AGUSH KOCIA
12_8229215 SABRI XHEMAL LUGA
12_8141826 XHEVAHIR ASLLAN BARDHI
12_8225250 XHAVIT XHEMAL HAJDARI
12_8230411 ALFRED SHEFQET PICALLI
12_8234317 XHEVAHIR BERZHAT KOLA
12_2209621 ARTUR BESIM DURRSI
12_2161729 VELI HAXHI BALASHI
12_2201751 KUJTIME ALI BILLA
12_8229300 RAHMAN MEHMET DELIU
12_8230897 GEZIM SOKOL ÇELA
12_8230896 KUJTIM RUSHIT SHPATA
12_2171579 NAIM HALIL KASA
12_2168000 RAMAZAN XHEMALI DOMI
12_2205314 YLLI DILAVER XHELILI
12_7000246,12_8225848 VEZIR JAHO SORRA
12_2164269 BASHKIM BAJRAM UKU
12_2201796 RIFAT ÇELNIK MIRASHI
12_2158869 KADRI HYSEN SALLA
12_3010652,12_8151242 PERPARIM ENVER HASALAMAJ
12_8230494 LUAN ZEQIR HOXHAJ
12_2209533 LULËZIM IBRAHIM SULAJ
12_8141124 FAIK IBRAHIM BELBA
12_8229717 "EURON "SH.P.K
12_8234316 INDRIT MUHARREM PLAKU
12_2204898 QAMIL MUSLI MUSLIA
12_2164000 BEHAR RIZA BEKA
12_8227109 HARILLA GAQI BOMBAJ
12_2167675 GEZIM ISLAM UKU
12_2171513 ROLAND QEMAL BULKU
12_2207039 FEIM MURAT MURATAJ
12_2161563 ÇLIRIM SINAN BEQIRI
12_8229188 MUSTAFA HALIL PREÇA
12_8227399 ALI ASLLAN GJECI
12_8223745 ELENA MEHMET TEMIM
12_8225915 VIKTOR SEFER CACI
12_2168912 XHEVAHIR ZYBER BIRAÇI
12_2201743 ILIR QEMAL PLAKU
12_2210755 ENVER BEQIR BODLLI
12_8142078 LEFTER ABAZ ZAJMI
12_8226298 ALI MEXHIT MEMA
12_2168113 SHEHAT EKREM GJORLLAKU
12_8229492,12_2165266 BEDRI DAUT BARDHI
12_2157408,12_8226158 SAMI SHAQIR SINANI
12_8151763 HYSNI SHEFQET KOCI
12_2164400,12_2169155 MUHARREM ALI KARAJ
12_8222711 AGRON ALI REXHEPI
12_8150637 PULLUMB BAFTJAR BARDHI
12_8152005 XHAVIT JAHJA KASAMI
12_8228494 TOFIK TELHA DEDJA
12_2164258 FITORE TAHIR HASA
12_2197841 SAZAN DITURIM TOPI
12_8230277 GENTIAN SURE LAMI
12_2165489 DRITAN MAHMUT SHAPHASA
12_2155402 NAZMI QAMIL SULA
12_8151093 BILBIL JAKUP LAMI
12_2168823 XHAVIT MEXHIT TROKSI
12_2159645 ESAT HASAN AJAZI
12_2163968 AGRON MUSTAFA TAKU
12_8228767 ADEM SULEJMAN METAJ
12_8223104 SHERIF RRUSTEM SULAJ
12_8227577 KORAB SHEFQET ZELA
12_8293577 HAJRI LUFTI LALA, SKENDER LUFTI LALA
12_8229442 MEXHIT JUSUF ALUKU
12_2155414 ILMI AQIF BILLA
12_8228993 BEQIR RESHIT FUÇIJA, LINDITA HAJRULLA FUÇIJA
12_2154551,12_8229997 SHABAN MUSTAFA MEMA
12_8230278 DRITAN BESIM GJATA
12_8227461 LUFTIM ISLAM TRIMI
12_2162444 HALIT KASEM TRIMI
12_2464397,12_2169152 KADRI SHABAN FJOLLA
12_2205312 YLLI ENVER BODILLI
12_2210828 LEONARD PRENG PERKEQI
12_2166314 ARDIAN GANI METANI
12_2168931 BLERIM HAJDAR BUSHI
12_8225961 THANAS ANDON REXHEPI
12_2210752 ENVER SEFER ÇAÇI
12_2165283,12_8230713 ISMAIL DALIP REXHEPI
12_2168592 XHELAL XHAFERR ENESI
12_2205258,12_2205259 MASKIM PAJAZIT ÇAUSHI
12_2161488 PETRIT ARIF PLAKU
12_4003316 ALI SINAN DARAKU
12_2182611 KORAB MUSTAFA MURATI
12_2168643 BESNIK SURE BIBA
12_2163840 LUAN MUSA RRUSHI
12_8229726 AXHEM MUHARREM DOMI
12_8230918 RESMIJE SULEJMAN HASA
12_8223361 SEFER ZYBER KASA
12_8152396 RAMAZAN JEMIN SHAPHASA,
12_2168903 RUFAT BAHRI MIFTARAJ
12_2166731,12_2170089 LORENA,ROMINA,ROMEO YLLI IDRIZI
12_2162482,12_8226249 GEZIM SHABAN LIKA
12_8223169 SHEFQET GANI HODA
12_8151937 RENALDO TEKI SHAHINI
12_8224690 KADRI HASAN AJAZI
12_8222971 YLBER XHELADIN HALILAJ
12_8142132 FUAT BAFTJAR SKEJA
12_2163946,12_8229814 HALIT SHERIF ZYBERAJ
12_8224690 RAMAZAN XHEMAL ÇULLHAJ
12_4003189 LIRI ABDULLA HAJDARI
12_2158206 MARIO AVDI MIRAKA
12_8308210 ENKELEDA, KRENAR RIZA BAKI
12_2167401 MIT-HAT DALIP MUÇA
12_2202519 MUHARREM NEBI ÇAUSHI
12_2197842 DITURIM ISUF TOPI
12_2158744 GENC PETRIT HURDHA
12_3011634 SHUKRIE XHELAL TOTA
12_2168900 DAUT QAMIL SHKURTI
12_2170299 DAUT QAMIL SHKURTI,
12_2208130, 12_8228508 FERIK SELIM MEMLIKA
12_8142561 SYRI HYSEN HYSENBELLI
12_8234242 ARTOR DED ALIAJ
12_8223100 GUXIM BAJRAM TROKSI
12_2168703 QEFSERE BEQIR TROKSI
12_8222985 LEONARD SKENDER TROKSI
12_8293714 ASLLAN RESHIT HOXHA
12_2202868 ALBAN QEMAL JASHARI
12_8230433 SABRI HALIL SORRA
12_8142719 HYSEN AVDULLA SHERA
12_2159648 ASTRIT IMER SHTISHI
12_8224421 SHUKRI ZENEL MUÇA
12_2155498, 12_8224168 AGRON RAMADAN BULICA
12_8224107 XHEVDET SHPETIM MEMAGA
12_8228014 FAIK BAJRAM BASHA
12_2170339 SOKOL PASHA MEHIDRI
12_2166677 SHEFQET HASAN XHEPA
12_2168545 PETRIT QERIM KASO
12_8225617 REFKI VELI LIKRAMA
12_2158243 KUJTIM MEDAT OSMANI
12_2203897 SHPRESA RAMADAN METHASANI
12_2180731 NESTI FRANG NDOCI
12_8308177 ARBEN HAXHI KURTI
12_8152162 ILLSON FIQIRI BILLA, DRITAN FIQIRI BILLA
12_2208590 KUJTIM QAZIM ALLMETA
12_8230806 HYSNI SELIM ÇELIKU
12_2165500 URIM BEQIR SELA
12_8228161 GEZIM EQREM TRIMI, SHKENDIJE AHMET TRIMI
12_8151102 LULZIM MUHARREM VALISI
12_8142346 DALIP SELMAN REÇI , DEFRIM SELMAN REÇI
12_2170392 GEZIM RIZA KRYPI
12_8223159 HYSEN AHMET MANSAKU
12_8228159 AVNI SHYQYRI META
12_8226347 DORJAN HAXHI BALLA

12_8227519 FITNETE BAFT LAMI
12_8150747 ALBERT HALIL HASA
12_2165799 HAJDAR ASLLAN MAHMUTAJ
12_8229279 EKTOR KAJO GJOROVENI
12_2162466 BERNARD HAMDI OSMANI
12_8230442 NUREDIN DERVISH BRESHO
12_8151232 HASAN XHEMAL MALAJ : LEONARD HASAN MALAJ
12_8151766 BESMIRA ISMAIL TUPI , FLORIONA PERPARIM RAMAJ
12_8152150 AFRIM RUSHIT DANGA
12_8142553 LULZIM MUHAMET BABOÇI
12_2165223 XHEMAL SHAQIR BLETA
12_8142189 ALTIN MAHMUT LAMI
12_2166374 AMILTON SINAN OSMANAJ
12_2197788 NEFAIL MALIQ SPAHIU
12_8228256 PULLUMB ALI HOXHA
12_8234440 LULZIM ADULLAH DUSHAJ : HEKURIJE HASAN DUSHAJ
12_8293940 REMZI METUSH LAHO
12_2204886 OSMAN SELIM CUKU
12_2167312 IBRAHIM OSMAN ISMAILAJ
12_8308202 BLEDIAN BEDERI MUÇA,
12_2186044;12_2205218 ARBEN NJAZI CAKA
12_2205779 SHAQIR SYL JAKU
12_8151920 SHPETIM BAKI MERJA
12_8224017 TOFIK QAZIM QERANA
12_2165463 FEHMI JEMIN LITA : DASH JEMIN LITA
12_8152007 MEVLUD BAJRAM MYRTA
12_2168728 ZOJE RIZA TROKSI
12_8228181 DESHIR ALI HOXHA
12_8220610 RUSTEM ABIDIN ISLAMAJ
12_8308201 SULEJMAN QAMIL GJYLA
12_8152247 SHEFQET DALIP ÇELA
12_2197768 ADRIAN NEXHDI DALIPI
12_2201865 HAZBEDIN NEHAT TOPI
12_8228810 IBRAHIM HYSEN XHAJA
12_8225719 IBRAHIM NEZIR SULAJ
12_8229497 DASHAMIR SHEFQET SPAHIU
12_2162367 LULZIM BAJRAM BASHA
12_8151428 YMER REXHEP ALLA
12_8224873 SHAQIR SHERIF ZHULLIMA
12_8219504 ARJAN RESUL ÇEPUNI
12_8223586 HAJDAR IMER MEMA
12_8224018 DURIM SKENDER SPAHIU
12_2197810 DHIMITRAQ AQIL GAQOS
12_2141886 HYSNI SHABAN MEMA
12_8224433 ARBEN QAZIM ZHULLIMA
12_2161690 QEMAL HAMZA HOXHA
12_2159574 GRIGOR SHERIF IMERI
12_8231153 DASHNOR AVDI GJANA
12_8151431 SADRI ADEM HAJDARAJ
12_2165150 XHEVAT HASAN LOZI
12_8227416 RESHIT MUHARREM BARDHI
12_2154607 PERPARIM BELUL KAPLLANI : MALVIN PERPARIM KAPLLANI
12_8228683 SHKELQIM DEMIR MAHMUTAJ
12_8223341 ILIR RAMAZAN HASIBRA
12_2158724 PANDI PALI RUPI
12_8151756 HAJDAR MYSLIM KOÇI
12_8227100 HANKE HASAN BULKU
12_8229640 HAKI BAJRAM XHAJA : ARJAN HAKI XHAJA
12_8224197 NIFE RAMAZAN DELIU
12_8226536 LEONARD VAID KARAJ
12_8227431 LULZIM BESIM ALHYSA
12_8150731 GENTJAN ABDYL STAFA
12_2161581 QEMAL MUHARREM HUSHA
12_8225686 MARIGLEN BESNIK HENSI
12_8293607 NAMIK HASAN BAJRAMMEMAJ
12_2164252 DURIM MUHARREM SEFERAJ
12_2158772 MUSTAF ELEZ BRAHIMI
12_3010864 ALQI FAIK HAJDINI
12_8141158 SHKELQIM SELIM ÇELA : ERVANA KALEM ÇELA
12_2206224 ILIR SULEJMAN VOGLI
12_30110864 SOKOL NDUE BUSHI : LEONORE DEDE BUSHI
12_2164240 ARBEN ALI PEKA
12_2166684 ABEDIN HALIL META
12_2168957 IMER MEHDI SELMANI
12_8178986 RAMADAN HYSEN LESKA : JUNIE HAJRULLA LESKA
12_2162672 KAPLLAN SHAIP GJINI
12_2171495 SAIMIR ALI LAMI
12_8230007 ÇLIRIM REXHEP KODRA
12_8229641 BUJAR HAXHI ÇULLHAJ
12_2201724 GAZMIRE QAMIL SKENDERI : ABERIM QENAM SKENDERI
12_8224451 SHIQERE HYSEN HYKA
12_4003509 TAFIL RUFAT FERATI
12_8225804 ASTRIT MUHARREM KARAJ
12_2111690 ADRIAN LATIF XHEPA
12_8228087 SHKELQIM TELHA XHAJA
12_8308193 BUJAR HASAN HIDRI
12_2135095 PETRIT NEZIR LULJA
12_8141455 LUAN HASAN BOSHNJAKU
12_8224008 SELAMI MUHAMET MEREPEZA
12_8308929 ASTRIT RABINAN BAFTSEFERI
12_3009785 VEIS MYFTAR HOXHA : VANGJELINA MYFTAR HOXHA
12_8223062 SOKOL SHEFQET ÇELMETA
12_8227149 SHKELQIM RAMAZAN LIKA
12_2141896 MURAT HALIM PECA
12_8234315 PETRIT ELEZ KOSHI

12_8228343 GENTIAN HAXHI HAXHI
12_8227563 NJAZI ISLAM KERCIKU
12_2202449 BARDHYL KODHEL DUZHA
12_8151781 ALTIN OSMAN TROKSI
12_8223502 ALEKSANDER SAHIT DAUTI
12_82222202 SEFEDIN BAHRI MEREPEZA
12_8142445 SHPETIM MUSTAFA SORRA
12_8223648 TRITAND RAMIZ SORRA
12_8224692 SEF HASHIM HYSA
12_8223621 THEODHOR EMIN DATJA
12_8150912 AHMET HAJDAR MURATI
12_2197748 PETRIT JAKUP KURTI
12_8228582 ISMAIL OSMAN ISMAILAJ
12_8142415 PETRIT RAMAZAN VELIJA
12_8220635 LUAN SHYQYRI GUXHA
12_2158964 HATIXHE HAZIZ KACA
12_8220634 SEHADETE FADIL GUXHA
12_8223675 ENVER BAJRAM DUKA
12_8224352 BESNIK NEXHIP SELMANI
12_2206280 ERJON ALI SINA
12_2162527 KOL NDUE KOLIÇAJ
12_8142414 KUJTIM RIZA TAFA
12_8293363 SHKURT SEFER HAKRAMA
12_8227697 QAMIL ABIDIM ISLAMAJ : ALIDIM QAMIL ISLAMAJ
12_8226002 ARJAN BAJRAM LALA : DASHAMIR BAJRAM LALA
12_8224380 DURIM AVDI AGEJA
12_8151072 BESNIK XHELAL MUHARREMI
12_2167553 OSMAN SHAQIR HAXHIJA
12_2205298 TURABI SAMI ALIU
12_8222695 ZIHNI SELMAN RAMA
12_2171494 SKENDER SHABAN ZENELI
12_2161328 NAZMI HYSEN RRUMBULLAKU
12_ 2144452 VASIL JONUS AGALLIU
12_2144451 GEZIM JONUS AGALLIU
12_4003528 LUTFI HALIT MEZINI
12_8224972 ADRIJAN PELLUMB SINA
12_8226332 NEXHIP ZEQIR FERATAJ
12_8225967 DASHAMIR SABRI SEFERAJ
12_8142555 LULZIM TUT SHIMA : XHEMALIJE MYSLYM SHIMA
12_2202759 BEDRI MAHMUT TOQI
12_2206984 BEDRI HARIF DELIU
12_8151374 MIREL QAMIL BALLA
12_8229360 ARTAN ZYBER META
12_2161520 DALIP HAMZA HAKA
12_8229273 SHEFKI MYSLYM LIKA
12_2155356 SULEJMAN LIMAN HOXHA
12_2201550 MELEQ DYLEJMAN HAKA
12_2164438 KUJTIM MUSTAFA MYRTA
12_8226535 MALIQ HALIL HAKRAMA
12_8223866 FESTIM KASEM VELIJA
12_8222930 PELLUMB RAMAZAN NOZLLI
12_8229965 SALI HAKI LULJA
12_2171502 BEKIM MUHARREM LAMI
12_8308270 JAK SHAN RAMAJ
12_8230474 FESTIM BEQIR SHIMA
12_8150962 ASLLAN RAHMAN HYKA
12_8150832 ARBEN FADIL LIKA
12_8229294 SELMAN SALI KULLOJKA
12_2135085 GEZIM ILJAZ HARIZI
12_3011641 ABDYL QAZIM HARIZI : BLEDAR ABDYL HARIZI
12_2168951 JONUZ BAJRAM BEÇA
12_2165853 HASAN SALI JAKUPI
12_2206322 GJOVALIN LLESH LEKA
12_8151402 SKENDER XHEMAL KALAJA : LINDITA SHABAN KALAJA
12_8222620 BLERIM MUHARREM LAMI
12_4003261 PULLUMB KAPLLAN HIDRI
12_2206292 FATIME IBRAHIM DOKO
12_4003515 QELIK LAZAM SHIRA
12_8224114 RAHMAN SHEFQET MYRTA
12_8227195 SABRI SULEJMAN KARAJ
12_8152204 SAMIR REFIK SULAJ
12_8142319 NDRIÇIM MAKSUT HOXHA
12_4003516 PJETER NDUE LULI
12_2161751 GEZIM XHEMAL BOZHA
12_2168972 URIM XHEMAL KACOLLJA : ARBEN XHEMAL KACOLLJA
12_2171566 SHEFKI SAID DUKA
12_8222287 XHEVAHIR ISLAM GRANA
12_3011544 PETRIT MYRTEZA ABAZI
12_3010588 OSMAN HASAN HOXHA
12_8304446 ZENEL HYSEN KULLOLLI
12_8224161 HALIT AHMET MANSAKU
12_2183378 KAJAME QANI ZAIMI : ALKETA ISLAM QAFOKU
12_8152368 SHKYLQIM REFIK MEREPEZA
12_8225854 PETRIT ISLAM ALLA
12_2141861 URAN RAKIP MEREPEZA
12_2208234 RAMIZ MAHMUT DUDA
12_2207001 DELI HAXHI PEPOSHI : DEMIR DELI PEPOSHI
12_8226532 XHEVDET SHABAN ZENELI
12_2155444 XHAVIT XHELAL LLESHI
12 _8228064 METUSH VEHAP BRIKA
12_8222878 SHERBET SHEFQET XHERAHI : DYLAVER SHEFQET XHERAHI
12_2162524 SHKELQIM METE HURDHA
12_2161447 LIMAN QAMIL GJYLA
12_2180625 ARBEN OSMAN KAMBERI
12_2183243 KONGRES RAKIP ALUSHANI
12_8293472 HASAN TAHIR PASMAÇIU

12_2171488 SHKELQIM SEJDIN LAMI
12_2169814 KLODJAN MAFMUT ALLDERVISHI
12_2191461 ERMAL BASHKIM MUHAMETAJ : ENTUENA BASHKIM MUHAMETAJ
12_2183296 FLUTURIM SULO DURDANJ
12_2162370 FADIL ISLAM ALLA
12_2154581 SHPENDI TAHIR AGAJ
12_2206355 ISA ISMAIL MEÇKA
12_8151550 ISMET LUTFI GJANA
12_2167424 LULZIM GANI METANI
12_2165107 MUHARREM HAMDI KASA
12_2158172 ARTAN AVDI MIRAKA
12_2161529 FATMIR DYLE RRUMBULLAKU
12_2206373 KAPLLAN HEBIP KOJNOZI
12_8150961 HIQMET DYLBER MULLAYMERI
12_8141582 ANDON MARKO KARAJANI
12_2112658 LIMAN XHAFERR HIDRI
12_8308846 KOLE KUJTIM ZMAJLI
12_8228272 BASHKIM MURAT NOZLLI
12_8223456 ZEQIR RAMADAN KOÇI
12_8142080 KAJMAK QAMIL FEZA
12_8261656 MUHARREM BEQIR HARIZI
12_2197819 PETRIT MALUSH AKROBATI,
12_8218813 LEONARD SELAMI MENE
12_8309004 HELIAN LEONIDHA XHIMA,
12_8309007 ROVENO NEBI QOKU
12_2162520 MEFAIL MEHDI NOKA, ARBEN MEFAIL NOKA
12_8224410 QAMIL XHEMAL GJIKA
12_8229228 MARJANA FETA HAJDARI
12_8226652 DESHIR OSMAN HOXHA
12_8308192 MIRJAN QERIM ALLKA
12_2162649 DRITAN ISMAIL ALMADHI
12_2167355 SAMI SULEJMAN NDREU : LUAN SULEJMAN NDREU
12_8293879 ADRIAN,ELTON,ARMAND MIT HAT HARIZAJ
12_2165111 ARANIT ADEM HYSTUNA
12_2165794 BEKTASH HAZBI SALIASI
12_8141580 JANI MIRKO KARAJANI
12_8227004 LUTFI MUHARREM TROKSI
12_211648 REXHEP SEJDI BINJAKU
12_2164298 LULZIM MURAT NOZLLI
12_8308967 HEKTOR NIAZI ÇEPANI
12_8308728 GEZIM MALIQ HIDA
12_8293343 SHKELQIM MEHMET MOLLA
12_4000174 VIOLETA HAXHI XHEBRAHIMI,
12_8308977 ILIR KASEM KASO
12_3011646 ARMEN HAXHI PALUSHI
12_2210754 ENVER VELI BEHAJ : SHQIPONJA ADIL BEHAJ
12_2162657 SHERIF RASIM KASAMI
12_2174218 VJOLLCA SHAQIR BAQOSHI, HATIXHE,BLEDJAN
12_2202873 ALBINA NURI MIRASHI
12_2168518 ASTRIT SEFER MEMA
12_2165827 SHPETIM DALIP RRAFMANI
12_8223764 HALIT HAXHI NOKA
12_8223509 PJETER LLESH MARKU
12_2170281 ZINI FIQIRI ZEBI
12_8226607 ZAIM IBRAHIM SHATRI
12_8224011 BAJRAM ALI BALLIU
12_2162600 RRUZHDI ABDULLA LLAKA
12_8151045 ARTUR AQIF BASHA : MUSTAFA AQIF BASHA
12_8227229 LUTFI SHAQIR AHMETAJ
12_8308209 MARJETA BEDRI TERPOLLARI : ALBANA BEDRI BIQE
12_8225947 SHERIF QAMIL ISUFAJ
12_2161746 AHMET ABDULLA SHEHU
12_8226513 LAVDRIM NAZMI ISUFAJ
12_8225916 VALBONA BAJRAM CANI : KLEMEND BEDRI CANI
12_2168699 HASAN MUSA QORDJA
12_2171340 RAMAZAN IBRAHIM SHURDHI
12_8142437 ADEM BEQIR KUKA
12_8224349 PETRIT SADIK NDREU
12_8229015 QEMAL LIMAN LAMI
12_2201857 SUBI HAMZA HASMETA : BEKIM HAMZA HASMETA
12_8229699 MAHMUT YMER SULA
12_8229346 SERAN HYSEN MAÇI
12_8226549 SERVET GANI KAÇA
12_2204921 RAMIZ ALI KARAJ
12 _2202832 VANGJEL IBRAHIM NELI
12_2207003 DEMIR NAZIF KRAHYSA
12_8308978 RIZA MAHMUT BUNACA : ARBEN RIZA BUNACA
12_8225337 AUTOR MUHARREM BRAHJA
12_8308198 XHEMAL YMER SULAJ
12_2164113 ARTAN BAJRAM HALILAJ : BAJRAM VELI HALILAJ
12_2203811 PETRIT ALI KARAJ
12 _4002962 MEÇAN SYTI SALIASI
12_8227567 MYFTAR ABDULLA KERÇIKU
12_4003508 MEFAIL RUFAT FERATI
12_2168545 PETRIT QERIM KASO
12_2210884 FADIL ISTREF KOPANI
12 _8227231 ISUF MUSTAFA KERÇIKU
12_2201790 RAMAZAN DALI MUÇA
12_2151098 ARJAN KURT DERVISHI
12_8150623 ALEKS BAJRAM MISKU
12_2158947 SHYQIRI RIFAT KURTI
12_2164291 MEVLUT ADEM HYSTUNA
12_4003511 ABDYL LUTFI SHIRA
12_8226381 ENVER ISLAM BEKA
12_8222888 BASHKIM HAKI PASMAÇIU
12_8225001 XHELADIN SHAQIR KARANXHA
12_8228456 BEXHET ESTREF CENKO
12_2168544 TAHIR BAJRAM QUKA
12_2204926 RENALD MYFIT DERVISHI : INDRIT MYFIT DERVISHI

*Pelegrinazh i madh botëror.*
*Merr pjesë Presidenti Republikës Ilir Meta*



# Dodona pellazgjike, Tomori, tempulli mitik më i lashtë në botë, kryemal i historisë së gjenezës shqiptare



Ferdinand Samarxhi
*Mjeshtër i madh*

Ka ditë që rrugët që gjarpërojnë dhe të çojnë në malin e Tomorit, në Teqenë e Abaz Aliut, në majën e tij Çukë ku dikur ngrihej madhështor tempulli më i lashtë i botës, i Dodonës pellazgjike, Orakull i Zeusit të kujtojnë ardhjen e qindra e qindra pelegrinëve që vinin nga të gjithë anët e botës përtej kufijve të kohëve të Ilirisë së Veriut e të tjera përreth saj. Tomori ngjason këto ditë me një qytezë të ngritur rishtas, në faqe mali, korijesh e lëndinash të tij ku nuk mungon asgjë me njerëz e net pa gjumë që të kujton si dikur festimet dhe aferomat që i kushtoheshin perëndisë së Apollonit, siç thotë Pindari festimet e këtyre anëve të Dodonës dhe krahinave përreth ishin ngazëllim për të.

Njerëzit vinin këtu në Dodonë, pranë bijës së oqeanit, të detit, të qiellit dhe të dheut, tempullit të saj që siç thotë Eskili, shekulli V p.e.s. tek "Prometeu i lidhur", 800, "… Kur ju të keni arritur në Tokën e Molosëve Të Dodonës së Sipërme ka një Orakull të Jupiterit Thesprot …" Në librin VI, VII ai shprehet se Tempulli i Dodonës gjendet në majë të një mali të lartë që është Tomori i sotëm, për t'u lutur dhe për të mësuar për fatin e ardhshëm të jetës.

Tomori, ky tempull i lashtë nis në histori nën një gurrë mitologjike dhe ngjitet deri në thellësi të shekujve ku vështrimi i studiuesve nuk arrin dot. Emri i tempullit të lashtë, Dodonës pellazgjike, sot Tomorit dokumentohet mjaft herët që në agim të shkrimit të poemave homerike. Emri dhe historia e tempullit të malit të Tomorit është e pandarë nga emri dhe historia e Dodonës, e cila është Orakulli i Zeusit. Homeri në poemën "Ilida" thotë:

"O Mbret Zeus, Dodonës Pellazgjike
që banon larg duke sunduar Dodonën
(Tomorin e sotëm) që e rrahin dimra të rëndë e të egër.
Këtu Zeusi deshi të ndërtohet
Faltorja më e vyer për njerëzinë,
Orakullin e Tij Dodonën Pellazgjike".

Historishkrojësi i vjetër P. Aravantioit, në librin e tij botuar në Janinë në vitin 1859 pohon: "Dodona ishte qendër pellazge para Helenike, shumë më e vjetër se gjuha, perënditë dhe mitologjia greke, si e tillë, ajo u njoh në krejt botën e lashtë dhe këtë realitet ekzistues e kanë pranuar vetë autorët më të moçëm helen".

Historianët mendojnë se Dodona mëmë ka qenë në Tomor dhe bijat në Janinë, Volos, Selanik, Itali. Gjurmimet në studimin e gjuhësisë, toponimisë, historisë, gojëdhëna e legjenda, gjurmime e zbulime arkeologjike, ndoshta një ditë do të identifikojnë Dodonën mëmë pellazgjike në Tomorin e Shqipërisë.

Hesiodi shek. VIII-VII p.e.s. pohon "Dodona dhe Lisi ishin qendra e Pellazgëve", se hyjnori Lykaon ishte i biri i Pellazgut, duke përforcuar kështu thënien e Homerit shekuj më parë, se Pellazgët, paraardhësit e gjenezës sonë ishin hyjnorë.

Herodoti fillimisht besonte se emrat e hyjnive vinin nga Egjipti, por duke kërkuar zbuloi se ata kishin ardhur nga barbarët. Origjina e fesë vjen nga barbarët, nga pellazgët dhe nga Shenjtorja Ilire Epirote e Dodonës. Prandaj Zeusi Perëndia më e fuqishme e mitologjisë greke, deshi që Dodona të ndërtohej në këtë majë të lartë (Tomor) dhe ajo të ishte Orakulli i Tij.

Herodoti që e ka vizituar këtë tempull, kur flet për profecitë e Dodonës, priftëreshat e tempullit në librin e tij thotë: "Dodona faltorja e saj, ka qenë më e vjetra nga gjithë të tjerat dhe më e para, tempulli më i lashtë mbi dhe".


Legjendari i Bektashizmit, Haxhi Dede Reshat Bardhi


Pamje televizive të fiksuara nga RTSH me rastin e përurimit të Odeonit

Hesiodi, libri i shtatë, fq.16, përmend si vend të faltores së Dodonës, qytetin Sella të Sellopisë. Në poemën "Carmina", Hesiodi jo vetëm përshkruan Hellopinë , por edhe cilësohet si atdheu i Dodonës.

… Është një fushë Hellopia, këtu në pjesën më të madhe. Është e nderuara Dodona Hellopia, fusha e Dodonës Pellazge, lëvduar prej Hesiodit qysh në shek. VIII p.e.s. vazhdon të thirret në gjuhën e vendit lopësia. Edhe vetë vendi rreth Dodonës u quajt Hellopia sikundër quhej edhe Eubea. Stefan Bizantini për të lidhur më mirë vijimësinë dhe ardhjen e gjenezës pohon se Hellopia me të cilën lidhet emri i krahinës është Gurra Mitologjike e emrit ku pozicionohet tempulli. Hellopi ishte i biri i Jonit, emri etnik i Hellopies, krahinë përreth Dodonës. Joni është i biri i Durrahut. Joni është edhe i biri i mbretit Ilir Adria nga mori emrin deti Adriatik. Gjiri Jonian është gjiri ku lindi Zeusi, deti i Kronit dhe i Reas, sipas Pierre Grimanit, vendi ku shtegtoi nimfa arkage, Io-ja e ndjekur nga Zeusi sipas Eskilit dhe Ovidid. Deti Jon në hershmëri të thellë përfshin edhe detin Adriatik.

Dionis Halikarnasi në librin e tij të parë thotë se Pellazgu ishte i biri i Zeusit dhe i Miobës së Foronit, Zeusi ka lindur në Arkadi, në viset e Shqipërisë së sotme, se Foronidha përfaqëson Jonë, Evropën, një nga gratë e Zeusit, se emri i nimfës lidhet me detin Jon.

### PRIFTËRESHAT E TEMPULLIT, GUGUTITNIN GJUHË BARBARE

Priftërinjtë që shërbenin në tempull, edhe popullsia në viset përreth fliste gjuhën e pellazgëve. Dhe vizitorët që vinin nga krahinat greke ishin të detyruar të merrnin vesh më përkthyes. Popullsia e Atamanisë(Aspropotam, nahijet e Xhumrekës e të Kalaritës) ishte pellazge, paraardhës të gjenezës sonë. Qendra shpirtërore e tyre ishte tempulli i famshëm i Dodonës.

Tri plakat e Orakullit të Dodonës, që përmend Straboni, lidhen me emrin e fisit "Graik"- "Gratë" që lokalizoheshin pikërisht në Epir. Fjala "Gra" është vendase, pellazge, ilire, shqipe. Sipas babait të historisë, Herodotit, feja helene e Athinës buron nga atdheu ku ndodhet Dodona, nga Arkadia, nga "Pleqtë", d.m.th. nga Pellazgë, nga Epiri. Sami Frashëri shkruan se edhe kohët më të lashta, të qytetëruara të Greqisë, Tempulli i famshëm i Dodonës që ndodhej në Epir, u përkiste pellazgëve. Gjeneza e vendit tonë që ka pasur disa Orakuj të Zeusit, jo vetëm në trojet tona por edhe në Libi e në Egjipt ka një Dodonë famëmadhe disa Orakuj të Zeusit, edhe jashtë Epiriote Toske.

Tradita mitologjike dhe historike dëshmon se banorët e lashtë të këtij vendi quheshin Arë, Argë, Arkadhë dhe më pas Pellazgë, Likaonë, Dorë, Kadmej, Heraklidë, Hylejë dhe në antikitet Ilir. Në kohët e historisë Homerike banorët e këtyre vendeve quheshin pellazgë, në antikitet epirot dhe ilir, sinonimet e emrave të përgjithshëm etnik kombëtarë të gjenezës tonë.

Dodona është ndërtuar në një epokë shumë të hershme, në epokën mitologjike. Lidhja Argë- Pellazgë- DodonëLikaone- Aiakas- Pirrej- Hyllej- Heraklide- Epiote- (Thesprote- Mollose) është lidhje vertikale e drejtpërdrejt e banorëve, e gjenezës sonë.

Homeri tek "Iliada" thotë: "Pas Enianëve vijnë Perrebetë, që banojnë rreth Dodonës dimërkeqe". Këto dy fise sipas Omerit ishin pjesëmarrëse në luftën e Trojës dhe banues pranë Dodonës Pellazge.

Pindari pohon: "Prej Dodonës nisin fushat ku kullosin gjedhët" , saktësisht fushat Dodoniane janë fushat para Tomorit, Myzeqeja, fusha e Shqipërisë Perëndimore, fusha e Elbasanit.

Dodona është vend malor… thotë Straboni, gjeografi Grekë. Talarët, fis i Molosëve, janë ata që banojnë pranë këtij mali, këtij vendi. Straboni na mëson se Orestët, banorët e Orestiadhës (krahinë e vjetër e Beratit) banonin në gjithë rrethin e Tomorit e Beratit, dhe morën emrin nga Oresti, i biri i Agamemnonit, komandantit të ushtrisë greke në luftën e Trojës. Dodona është ndërtuar nga banorët vendas të Epirit, nga më të moçmit, Pellazgët, Arkadhët dhe Tirrejtë.

Në librin e dytë Dionis Halikarnasi pohon se Enea arriti në Dodonë me ushtarët më të zgjedhur, për të kërkuar mendimin e perëndisë, ku gjetën edhe ata trojanë që kishin ikur bashkë me Helenën. Enea mbërriti në vendin e Enianëve, me të cilin e lidhë jo vetëm emri i përbashkët por siç duket edhe origjina. Halikarnasi fakton se pjesa më e madhe e pellazgëve shkuan tek aleatët, vëllezërit e tyre në Dodonë, kundër të cilëve askush nuk mendon-


Presidenti Ilir Meta drejtëpërdrejtë në RTSH duke përshëndetur nga festa e Malit të Tomorit, Abaz Aliut


Ferdinand Samarxhi drejtëpërdrejtë në RTSH duke transmetuar festën e Malit të Tomorit, Abaz Aliut


Tempulli i lashtë i Dodonës në Epir


Abaz Aliu shejëtori i epopesë së Qerbelasë


Tempulli i lashtë i Dodonës -Tempulli i Abaz Aliut

te të bënte luftë, sepse ishin të shenjtë. Meqenëse vendi nuk i ushqente dot të gjithë me porosi të Orakullit të Dodonës, u hodhën në Itali, në Ombri, në lumin Pad ose Spinë.

Në lashtësi figurohen disa qytete Epiriote me këtë emër, por edhe gjiri Elatea në Efyrë. Diku mes Gjirokastrës dhe Sarandës së sotme figurojnë dy qytete Helanon dhe Helakranon, fjalë ku në rrënjë të tyre gjendet helliopia, helloi, selloi, ahello, hellan me rrenjët "hell" duke faktuar se mishi i therur për nder të Zeusit dhe Dodonës pellazgjike piqej në hell, si blatim për perëndinë. Këtu e ka prejardhjen edhe kurbani që bëhet sot në Tomor, Dodonën pellazgjike, që nga thellësitë e lashtësisë së kohëve që kanë ardhur dhe vijojnë edhe në ditët e sotme. Gjithë Epiri është "helli", " selleis", vendi i shkuljes në hell të mishrave të pjekur si flijim dhe blatim për perëndinë.

## TOMORI PERËNDI E GJITHË SHQIPTARËVE.

Popullsia rreth Ilirisë e më tej e quante atë vend të perëndive, citon – Gesandtlen Erich Luckwald.

Çdo vit këtu mblidhen besimtarë të të gjitha feve për të festuar ditën përkujtimore të tempullit.

Roland Mathw thekson se çdo vit, në ditë gushti, bëhej një pelegrinazh në majë të tempullit dhe flijoheshin shumë kafshë në adhurim të dikujt a të diçkaje, që nuk mund ta thoshin. Qindra e qindra besimtarë të krishterë dhe besimeve të tjera ju bashkoheshin vargut të pelegrinëve.

Tempulli i lashtë i Dodonës lidhet me historinë dhe legjendën e ardhjes së shenjtorit të luftës së Qerbelasë, Abaz Ali në Tomor siç thotë rilindasi ynë i madh Naim Frashëri në poemën "Qerbelaja".

…Ç'është ai që shkon kaluar
Ikën si veriu
me dy tre foshnja në duar
është Abaz Aliu…
Abaz Ali zu Tomorrë
Erdhi afër nesh
Shqipëris s'mbet e gjorë
Se Zoti atë e desh.

Në fushën përvëluese të Qerbelasë, kur Abaz Aliu vuri re buzët e thara dhe të përlotura të fëmijëve të Imam Hysenit rrëmbeu kacekun dhe u nis për të dhënë provimin më të madh të jetës së tij.

Mitologjia na kujton se, Abaz Aliu në malin e Tomorit erdhi, jo vetëm për të mëkuar foshnjat, por u mëkua nga ky vend, trashëgoj fuqitë e tij të mbinatyrshme dhe prej këndej pas pesë ditësh shkoi në Olimp prandaj dhe pelegrinazhi në malin e Tomorit që nga koha e ardhjes në të e Abaz Aliut, sipas legjendës kremtohet nga data 20-25 gusht, për pesë ditë rresht, në përkujtim, në përkujtim të ditëve të qëndrimit dhe të largimit të tij.


Kampingu madhështor nga peligrinazhi i malit të Tomorit

Hysen Tusiu, misionar i parë që përhapte kuranin e atëhershëm, të shkruar me dorë, Islamin me simbolin e tij shpatën, kishte ardhur në trojet tona me një torbë dhe të marrë nga vendi ku kishin rënë dëshmorët e Qerbelasë, Imam Hyseni dhe Abaz Aliu. Duke mësuar se në këto troje gjendej tempulli më i lashtë i Dheut, faltorja e Dodonës dhe Orakulli i Zeusit, vendi më i parë dhe më i hershëm i shenjtë siç pohon dhe Homeri, populli më hyjnor, vendosi dhe erdhi pikërisht në këtë tempull, në majën e tij më të lartë, varrosi torbën me dhe, duke krijuar kështu mekamin e Abaz Aliut. Duke qenë se Bektashinjtë përqafojnë më mirë se kushdo lëvizjen e thënies së Profetit Muhamet se "Pa Atdhe nuk ka Fe" dhe duke u nisur nga vetë jeta e heronjve mitik, që jeta e tyre ishte përkushtim për perënditë, u përkujdesën veçanërisht në shërbim të shenjtërimit të këtij tempulli të lashtë.

Që në atë kohë tradita vazhdon edhe në ditët e sotme pa dallim midis besimeve se bektashizmi është ndër primarët e harmonisë dhe bashkëjetesës fetare.

Gesandtlen Erich Luckwald duke folur për shenjtërinë e këtij tempulli të shenjtë për kohët e hershme mitike e të më pasme citon se çdo vit këtu mblidhen besimtarë të të gjitha feve për të festuar ditën përkujtimore të tempullit nën drejtimin e klerikëve bektashinj


Qerbelaja një histori e madhe për njerëzimin


Ferdinand Samarxhi, Qerbelaja epope ngdhënjyese e demokracisë së njerzimit

Roland Mathw duke folur për këtë tempull të lashtë të Dodonës, Tomorit të sotëm thekson se qindra e mijëra të krishterë iu bashkuan vargut të pelegrinëve. Tomori është perëndia e të gjithë shqiptarëve, të krishterë e myslimanë…

Miti i lashtë i Dodonës pellazgjike –heroi i Qerbelasë, Abaz Aliu, Simbol pelegrinazhi, adhurim i hershëm dhe i sotëm

Njerëzimi në historinë e tij krahas nevojës që ka ndjerë për t'iu drejtuar perëndisë ka treguar gjithmonë forma lavdërimi për të, për shenjtorët, për vendet e tyre. Një prej formave është dhe venerecion shenjtërimit të vendeve, vendprehjeve të shenjtorëve që i kanë cilësuar si vende të shenjta dhe të adhuruara. Libri i kuranit të shenjtë duke treguar historinë e shtatë shenjtorëve te Efisit (Ephesus) thuhet. "Ne bëmë që historia e tyre të jetë publike në mënyrë që populli të dinte që premtimi i zotit është i vërtetë dhe se nuk ka dyshim, për ardhjen e datës së gjykimit". Ata filluan të diskutojnë me njëri –tjetrin mbi çështjen (e ringjalljes), dhe disa thanë: "Ndërtoni atyre një ndërtesë (të jetë e shenjtë) zoti i tyre di më mirë për ta (Sure El-Kehf, vargu 21, fq.342)". Ndërtesa të tilla, janë ndërtuar pa pushim nga njerëzit për të kërkuar bekime nga profetët, shenjtorët për të treguar respekt dhe për të praktikuar ceremonitë dhe ritualet e përcaktuara të adhurimit të tyre.

Çështja e të vizituarit të vendprehjeve të profetëve, pasuesve të tyre shenjtorëve, ka qenë një traditë e pandërprerë, e cituar nga fjalët e profetit Muhamet a.s., veprat dhe pohimet.

Nga ditët profetike thuhet se: "Kur ta ndjeni veten ngushtë do t'i drejtoheni vendeve të mira, ata e dinë hallin tuaj". Vendprehja Kanotaf e Abaz Aliut është një prej shtëpive mbi të cilën zoti i plotfuqishëm tha: "Shtëpitë që Allahu ka shpallur që të jenë tepër të respektuara dhe emri i tij të përmendet aty me nderim në mëngjes dhe në mbrëmje (kurani 24-36)". Të vizitosh Abaz Aliun sot pas vdekjes së Tij, është njëlloj si ta vizitosh atë gjatë jetës së tij. Kjo sepse profetët, shenjtorët, martirët janë gjallë me zotin e tyre.

Kurbani i malit

Njeriu gjithnjë ka ndjerë nevojën t'i drejtohet zotit, gjë që e ka manifestuar në forma dhe mënyra të ndryshme nëpërmjet saktifikimit të vetvetes, forma që ka kërkuar të përfitojë simpatinë e zotit dhe të meritojë dhuntitë e tij. Flijimi i njerëzve në religjionet e vjetra dhe primitive është shprehje tipike e besëtytnive që ka pasur forma të tmerrshme jo humane. Këto forma sakrifice, latinët i quanin "do ut des" Jap që të më jep mua. Këto raporte në Islam janë të panjohura. Duke qenë se njeriu është qenie jo e përkryer zoti gjatë gjithë historisë ka çuar për njerëzit, të dërguarit e Tij, Profetët, në kohëra të ndryshme për të ndihmuar njeriun në çdo drejtim dhe në pikëpamje të flijimit duke humanizuar sakrificën, duke fisnikëruar atë e larguar nga motivet primitive, supersticioze, egoiste, idhujtare më motive fetare altruiste, humane dhe sociale.

Kurbani është akt i flijimit sublim, i gatishmërisë së njeriut për të flijuar gjënë më të shtrenjtë, më të dashur që posedojmë në emër të krijuesit, jo për t'i bërë qefin krijuesit, por për se ndërtimin e porosive të fjalëve të krijuesit për mirëqenien tonë individuale dhe shoqërore. Zoti është i plotë mjaftueshëm, jashtëkohor, hapësinor dhe nuk është i ndikuar nga ligjet dhe rregullat e botës ekzistenciale. Zoti vërtetë nuk ka nevojë për askë në tërë botën. Thelbin, esencën e kurbanit e shpjegon vetë Zoti në Ajetin Kuranor. Tek Allahu nuk arrin as mishi (i kurbanit) as gjaku i tyre, por tek ai arrin Takvallëku juaj (devotshmëria). Kjo do të thotë se kafsha e flijuar është ndërrim simbolik me atë që njeriu duhet flijuar. Shembulli më i mirë për këtë është Hazreti Ibrahim, i cili si baba pranon të flijojë të birin Ismailin dhe shembulli i Ismailit që pranon të flijojë gjënë më të shtrenjtë vetveten. Rasti i Ibrahimit a.s. dhe Ismailit a.s. është rast i papërsëritshëm në historinë njerëzore dhe si i tillë duhet të ndikojë insipirativisht tek ne në kohën tonë kur po humb çdo vlera, kur njeriu po humb të qenit njeri.

Vetëdija se flijimi i një pjese të krijesave të tjera në dobi të një pjese tjetër- është çelësi i shpëtimit të një bashkësie nga shkatërrimi i kategorive etike dhe besimit është shkalla më e lartë që kurani kërkon të arrijë tek qenia njerëzore e tij, lartësimin e ndërgjegjes dhe jo degradimin e saj. Pra, kurbani është rast unikal simbolik dhe praktik i demonstrimit të besimit që ndikon të unifikohet dimensioni shoqëror dhe religjioz.

Në këtë kontekst tradita vazhdon dhe në Tomor ashtu si dikur që bëheshin kurbanet në blatim dhe kushtime ndaj perëndisë edhe sot ky rit vazhdon si dimension njerëzor religjioz. Për rreth pesë ditë në Tomor vijnë te ky tempull i lashtë i Dodonës pellazgjike, te ky tempull vendprehje e Abaz Aliut rreth 500 mijë pelegrinë, të cilët luten, adhurojnë, blatojnë zemrat e tyre për perëndinë.





Foto nga koncert i orkestrës kineze të flautit

Qindra të ftuar në evenimentin e muzikës instrumentale bazuar në kulturën kineze e shqiptare

# Koncert i orkestrës kineze të flautit, Klosi: Falenderim për "Prestige Resort"

## *Ministri i Turizmit: Të shpalosim dhe ne kulturën tonë në Azi*

Qindra të ftuar kanë mbushur mbrëmë resortin "Prestige" në Golem ku performoi orkestra kineze e flautit të bambusë e përbërë nga muzikantët më të rinj të Kinës. Orkestra ndodhet në Shqipëri si pjesë e turit në Europën Lindore dhe atë Qendrore dhe interpretoi muzikën instrumentale të bazuar në kulturën kineze të përshtatur me mjeshtëri e stil modern.

Të shumtë janë të ftuarit në "Prestige Resort" për të ndjekur këtë koncert. I ftuar ishte dhe ministri i Turizmit, Blendi Klosi, i cili vlerësoi punën e resortit për krijimin e një ambienti mikpritës. "Prestige Resort" e ka bërë punën siç duhet për të pritur trupën e orkestrës kineze. Ka krijuar një vend shumë mikpritës, shumë festiv e të bukur. Është e disata herë që vij në këtë mjedis për shfaqje të ndryshme.

Duhet të shpalosim dhe ne kulturën tonë në Azi, ne kemi një numër të shtuar turistësh kinezë në vendin tonë. Është e domosdoshme që turizmi i largët aziatik, e sidomos ai kinez të prekin vendin tonë", tha Klosi.

Ministri i Turizmit falenderoi ambasadoren kineze me të cilën ai tha se kanë bashkëpunuar për të rritur shkëmbimet e turistëve mes dy vendeve.

"Shqipëria duhet të jetë më e prekshme nga turizmi kinez. Falenderoj kryetarët e bashkive Durrës dhe Kavajë pasi realisht me ta ja dolëm të kishim një sezon turistik të suksesshëm. Gjërat kanë ndryshuar për mirë. Vazhdojmë të krijojmë Shqipërinë europiane dhe turistike.

Shumë faleminderit presidentit të 'Hysenbelliu Group' që na ka organizuar këtë mbrëmje", deklaroi Klosi.

Të pranishmit u shprehën në mikrofonin e "News 24" se ishin të surprizuar nga koncerti muzikor i flautit të bambusë.

Ambasadorja Jiang Yu u shpreh mjaft e kënaqur për mbajtjen e koncertit të flautit të bambusë nga muzikantët e talentuar të Kinës në "Prestige Resort".

Presidenti i nderit të PDIU-së, Tahir Muhedini si një pushues i thjeshtë dhe i ftuar në koncert u shpreh se "organizimi ishte i përkryer" dhe se falenderonte veçanërisht presidentin Hysenbelliu.

Resorti "Prestige" është një resort me vlerë në Ballkan", deklaroi Muhedini në mikrofonin e "News 24". Ai u shpreh i kënaqur që kishte mundësinë të njihej më tej me folklorin kinez.

**AMBASADORJA KINEZE**

Ambasadorja e Kinës në Shqipëri, Jiang Yu Ambasadorja tha se ishte mjaft e kënaqur për mbajtjen e koncertit të flautit të bambusë nga muzikantët e talentuar të Kinës në "Prestige Resort". Të pranishmit u shprehën në mikrofonin e "News 24" se ishin të surprizuar nga koncerti muzikor.



Organizatorët dhe të ftuarit në koncertin e orkestrës kineze, mbrëmë në "Prestige Resort"

**MIRENJOHJA**

Presidenti i nderit të PDIU-së, Tahir Muhedini i ftuar në koncert u shpreh se "organizimi ishte i përkryer" dhe shtoi se falenderonte veçanërisht presidentin Hysenbelliu. "Resorti 'Prestige' është një resort me vlerë në Ballkan", deklaroi Muhedini në mikrofonin e "News 24".

### RELAKS NE ADRIATIK

## "Prestige Resort", destinacioni turistik më i frekuentuar në vend

Prestige Resort Dikur njihej me emrin "Mak Albania", por tashmë ai është bërë pjesë e "Hysenbelliu Group" e mban emrin "Prestige Resort", me vendndodhje në Golem, buzë detit Adriatik. Shtrihet në një nga plazhet më të bukur në Shqipëri. Ky kompleks turistik u përurua në vitin 1998. Për shumë vite, ky resort turistik, i konceptuar me vila të vogla, ka qenë për destinacioni më i frekuentuar në vend, duke ofruar bukurinë dhe relaksin për ditët e pushimeve. Në 2014, kompleksi u ble nga



grupi "Hysenbelliu Group". "Prestige Resort" është emri i ri me të cilin u pagëzua ky resort. Pas një rikonstruksioni total të ambienteve të mëparshme dhe pas një rikonceptimi modern, "Prestige Resort" synon të jetë destinacioni turistik më i frekuentuar në rajon. Një nga komplekset me vizion dhe më tërheqës për pushuesit brenda dhe jashtë Shqipërisë, të cilët do të jenë në qendër të vëmendjes, sa i takon shërbimit dhe akomodimit.

TESTI I THJESHTË PËR VETËM PESË MINUTA ZBULON GJENDJEN TUAJ SHËNDETËSORE

SUMMER pages
SUPLEMENT I GAZETA SHQIPTARE
E mërkurë 22 Gusht 2018



## ENCA ÇMEND FANSAT, BËN TWERK NË KONCERT



## Ana Lika i kthehet keq fanses, ja çfarë i thotë

BULEVARDI POLITIK



- "Sa me naze kërcen plaka!" deputetet e LSI-së ia marrin valles në Jalë
- Ministrja shkon për të lindur me biçikletë: Nuk kishim vend në makinë
- Deputeti zhvishet në parlament, protestön kundër presidentit
- Trump në "luftë" me mediat; 350 redaksi lajmesh i kundërpërgjigjen



Rrëfehet DJ: Eksperiencat e mia në diskotekat me famë botërore, fansat më duan

# FLOR BANA: Ja kur do të vijë bashkëpunimi me Stresin, jemi miq të ngushtë

"Asnjëri nga ne nuk ka kapur qiellin me dorë"

### Rrëfehet DJ: Eksperiencat e mia në diskotekat me famë botërore, fansat më duan

# Flor Bana:

# Ja kur do të vijë bashkëpunimi me Stresin, jemi miq të ngushtë

*"Asnjëri nga ne nuk ka kapur qiellin me dorë"*

**Egla Xhemali**

Ai është DJ më IN i momentit. Është kudo ku ka evente dhe organizime të mëdha. Çdo ditë është mësuar të elektrizojë klubet dhe të sjelli një sërë surprizash me energjinë që e karakterizon. Bëhet fjalë për Flor Banën. Për "Summer Pages" të "Gazeta shqiptare", DJ rrëfen pasionin dhe profesionin e tij, raportin e ngushtë që ka me Stresin, ecurinë e muzikës dhe mbështetjen e fansave. Flori pohon se është i lumtur me atë që bën dhe se nëse do kishte zgjedhur një profesion tjetër përsëri do kishte lidhje me muzikën. Ky pasion i hershëm ka nisur që në fëmijëri për t'u thelluar përgjatë viteve e për t'u bërë më vonë profesioni i tij. Për të është shumë i veçantë raporti që ka me Stresin, ku përpos punës i bashkon dhe miqësia e ngushtë. Bashkëpunimet me të kanë qenë tejet të suksesshme dhe këngët janë kthyer hite për publikun, që vazhdon ti dojë edhe sot. Bana tregohet optimist për ecurinë e muzikës shqiptare duke e vënë theksin tek stili "Hip Hop Trap", që ka hyr në treg. Edhe pse ka prekur diskoteka me famë botërore dhe u ka dhuruar kënaqësi shumë njerëzve ai di të jetë me këmbë në tokë. DJ thekson faktin që nëse do të realizosh punë të mira padiskutim që duket të punosh fort që të arrish drejt suksesit. Të gjithë e mirëpresin dhe e duan kur performon. Marrëdhëniet me fansat i ka shumë të mira. Sipas tij askush nuk e ka kapur qiellin me dorë, që nënkupton faktin që ai ngelet i thjeshtë edhe pse ka famë. Si të gjithë artistët, natyrisht, që edhe Flori e ka synim tregun e jashtëm. Ai tanimë është njohur me të dhe ka rrëmbyer disa sukses. Së fundmi, Bana na zbulon se shumë shpejt do këtë surpriza nga ai dhe Stresi. Deri atëherë na ngelet vetëm të presim.





**Si po shkon për ty kjo verë?**
Ku ke zgjedhur të pushosh? Vera deri tani ka qenë shumë intensive për shkak se kam pasur një tur në Shqipëri dhe jashtë kufijve, në të gjitha klubet verore. Akoma nuk kam vendosur ku do pushoj, pasi pushimet e verës për mua fillojnë në mes shtatori dhe normalisht do jem diku jashtë ku bën ngrohtë. (qesh)

**Të kemi parë shumë aktiv nëpër evente të ndryshme. Ku e gjen Flori gjithë këtë energji?**
Shumë njerëz ma bëjnë këtë pyetje. Jam akoma shumë i ri dhe kam shumë për të treguar, për të dhënë. Sa herë jam në stage kur performoj mundohem që të jem sa më aktiv me njerëzit, të jem sa më i drejtpërdrejtë në performancë. Kjo të bën të jesh ndryshe dhe njerëzit këtë lloj thjeshtësie e pëlqejnë. Energjia është pjesë e karakterit tim që më shoqëron përgjatë të gjitha ditëve.

**Si është të bashkëpunosh me Stresin?**
Di të them që në radhë të parë është marrëdhënia shoqërore që kemi bashkë, të dy jemi korrekt sa i përket punës. Është privilegj të punosh me Stresin, pasi është i madh si artis e padyshim dhe në shpirt. Unë e veçoj nga të gjithë reperat e tjerë, sepse ai është shumë real. Kjo e bënë mjaft të veçantë për mua.

**Në qoftë se nuk do ishe DJ, çfarë profesioni tjetër do kishe zgjedhur?**
Nëse nuk do isha DJ padyshim do kisha zgjedhur diçka tjetër që do kishte lidhje me muzikën. Muzikën që fëmijë e kam dashur shumë dhe jam rritur në këtë frymë. Është pasion që të ndjek gjithandej dhe të bëhet i domosdoshëm pastaj. Në njëfarë mënyre të bëhet esencë e jetës.

**Ç'mendim ke për ecurinë e muzikës shqiptare?**
Për muzikën shqiptare di të them që po ecën shumë dhe po evoluon me ritme mjaft të shpejta. Kjo për faktin se nuk ka ngelur vetëm brenda vendit, po dhe artistët e huaj kanë filluar ta njohin. Në Shqipëri është futur dhe stili "Hip Hop Trap", që në Amerikë është IN dhe kjo është arritje për tregun tonë muzikor.

**Çfarë ndjesie është të jesh DJ më "In" i momentit?**
Të jesh DJ më IN i momentit është diçka që nuk arrihet lehtë. Kur kjo pikë arrihet njerëzit të duan, të mbështesin. Ka arritur stadi, që ti të jesh në çdo ditë të javës në klube të ndryshe dhe të kesh lloj-lloj aventurash, surprizash. Është e jashtëzakonshme ndjesia që publiku të suporton në çdo klub ku ti je. E vetmja gjë është për atë, atij i dedikohet gjithçka.

**Cila është rryma më e pëlqyer për publikun?**
Në Shqipëri rryma më e pëlqyer për publikun është komerciale. Akoma nuk është bërë një trend i veçantë që dikush të pëlqej techno, një tjetër hip-hop ose të ketë klube të ndara. Në çdo klub luhen të gjitha llojet e muzikave.

**Çfarë objektivash ka Flori për të ardhmen?**
Unë sapo e kam nisur këtë rrugëtim. As vet nuk e kam pritur suksesin që kam pasur me dy këngët e para 'Fake love" dhe 'Sa herë e don". E fundit ka qenë dhe në festivalin "Kënga magjike" ku është rrëmbyer dhe një çmim. Unë tani sapo kam nxjerrë dhe këngën time më të re në bashkëpunim me Anxhelo Koçin, që quhet "Mos ta nin". Deri tani po ecën mirë. Njerëzit e kanë pritur mirë. Kemi shumë surpriza të tjera, po do ia lëmë kohës që t'i zbuloj.

**A e synon tregun ndërkombëtar?**
Normal që po. Mos të them që jam nga të vetmit DJ shqiptar kaq i ri, që ka luajtur në super diskoteka me famë botërore si 'Jojo Beach Bar' që është një super bar i madh në Santorini, për të vazhduar pastaj me klubet në Xhenova, në Firence, që DJ të tjerë shqiptar nuk kanë arritur deri atje. Ky absolutisht që është një hap i rëndësishëm në karrierën time, që do i hapi rrugë të tilla sukseseve të tjera përtej kufijve. Nëse punon fort dhe ke vullnet për të realizuar më së miri atë që di të bësh atëherë asgjë nuk është e pamundur. Puna dhe vullneti janë çelësat kryesor që të orientojnë drejt suksesit.

**Si i ke marrëdhëniet me fansat?**
Marrëdhëniet me fansat i kam shumë të mira pasi unë jam i thjeshtë. Fundja asnjëri nga ne nuk ka kapur qiellin me dorë. E vetmja gjë që të çon para është puna si rrjedhojë pas saj vjen suksesi i merituar.

**A ka ndikuar fama në marrëdhëniet me gocat?**
Normal, pasi të gjithë duan të bien në qendër të vëmendjes. Kur unë jam në stage të gjithë vijnë aty. Janë gjëra që ndodhin gjithmonë, po nuk duhet mohuar që është të nice. Më saktë le të them të gjithë sytë i kanë tek ty, tek ajo që ti bën më së miri. Kënaqen nën ritmet e muzikës dhe më vlerësojnë për punën.

**Të gjitha këngët që Stresi ka realizuar me ty kanë rezultuar shumë të suksesshme. Keni ndonjë surprizë tjetër për fansat?**
Po është e vërtetë. I përmenda dhe më sipër dy këngët e mia të para, që patën një sukses shumë të shpejt që të them të drejtën nuk e kam pritur. Jam surprizuar. Mendoj se fillimi i tetorit do këtë një bashkëpunim mes meje dhe Stresit. Mbetemi në pritje deri atëherë.



# LINDA REI PUBLIKON FOTO INTIME ME NJË MASHKULL




Linda Rei është kthyer në një nga femrat më të komentuara të show bizit shqiptar që pas deklaratës së saj mbi ndërrimin e gjinisë dhe pjesëmarrjes në spektaklet e kërcimit. Make up artistja tanimë ka fituar vëmendjen e të gjithë dhe publiku ka shumë kuriozitet mbi të rejat nga jeta e saj private. Rei ka qenë mjaft aktive me fotot në rrjetet sociale. Së fundmi, ajo ka publikuar një imazh në 'Instagram' ku shihet një mashkull vetëm me të brendshme. "Tani më jep një kafe, të lutem", ka shkruar Linda mbi foton e postuar.




# ANA LIKA I KTHEHET KEQ FANSES, JA ÇFARË I THOTË








Njihet si vajza rebele që bën gjithçka dëshiron, pa pasur frikë. Ana është bërë e njohur për natyrën e saj të çlirët që dhuron humor për publikun. Së fundmi, ajo ka nisur pushimet nga ku ka realizuar disa foto sensuale dhe njëkohësisht shumë të guximshme. Ajo ka postuar një foto mjaft provokuese, që si gjithmonë ka ngjallur debat tek komentuesit. Madje njëra nga ndjekëset është kapur me formën e buzëve të Anës duke i quajtur si kremviçe, por kjo gjë si ka pëlqyer aspak Anës dhe nuk ka hezituar t'i përgjigjet." E mi kuklle ashtu i kam! Du me dit ku të çalon muhabeti!", i thotë Ana, ndërsa ajo i thotë "askund ylli" dhe Ana ia kthen "Epo rri pra ç'ke që komenton".

# ARILENA ARA, NUK E KENI PARË KURRË KAQ SENSUALE

Ajo është një nga këngëtaret më të dashura për publikun shqiptar dhe jo vetëm. Arilena Ara ndërkohë që është duke shijuar sukseset e njëpasnjëshme në skenat e mëdha përtej kufijve nuk harron dhe të jetë aktive për të gjitha ata që e duan në rrjetet sociale. Bukuroshja ka publikuar në "Instagram" një foto ku shfaqet më në formë se kurrë. Tërësisht pa make-up ajo duket mjaft tërheqëse. Nuk dihet nëse Arilena është duke përgatitur ndonjë produksion të ri muzikor, pas suksesit që pati me këngën "Nëntori", e cila pati edhe jehonë të madhe.




# ENCA ÇMEND FANSAT, BËN TWERK NË KONCERT



Ajo është një nga këngëtaret më të komentuara të momentit kjo për shkak të postimeve mjaft provokuese dhe sukseseve të shumta që e kanë sjell deri këtu. Bëhet fjalë për Encën. Bukuroshja ka qenë tepër aktive me postimet e saj në këto ditë të nxehta vere. Së fundmi, Haxhia ka publikuar në rrjetin social "Instagram" një video, në të cilën bën twerk përpara fansave të saj në koncert. Në këtë video e shohim mjaft sensuale dhe provokuese këngëtaren e njohur, e cila njihet për këto lloj performancash.



# Testi i thjeshtë për vetëm pesë minuta zbulon gjendjen tuaj shëndetësore

**Bëjeni menjëherë në kushtet e shtëpisë suaj dhe mësoni a keni nevojë për ndihmën e mjekut! Mund të bëhet në kushtet shtëpiake, ndërkaq zbulon sekretet mbi gjendjen tuaj shëndetësore.**

**Ajo që është më e mira nga e gjitha, për çdo verifikim (gjithsej janë pesë) nevojitet vetëm një minutë.**

*TESTI PËR VERIFIKIMIN E SHIKIMIT*

Shikoni në kornizën e derës apo të dritares së madhe në dhomë një herë me syrin e djathtë (mbulojeni me dorë të majtin rreth 30 sekonda), pastaj shikoni me syrin e majtë.

Çfarë do të thotë kjo: Do të duhej t'i shikonit skajet e kornizës, si edhe linjat paralele vertikale dhe horizontale. Nëse skajet e kornizës ju duken të shtrembëruara apo ju duken zigzage, kjo do të thotë që keni degjenerim makular.

Degjenerimi senilmakular, i cili është i zakonshëm te personat e moshës mbi 50 vjeç, mund të çojë deri në verbërim, ndërkaq njëra ndër shenjat e para, të cilat tregojnë këtë (mund të shfaqen në formë të linjave valëzuese dhe të shtrembëruara) gjithnjë e më të vogël shikimin qendror dhe me intensitet më të dobët ose ngjyra të theksuara. Sa më parë bëni kontrollin mjekësor.

*TESTI PËR VERIFIKIMIN E ERËS KUNDËRMUESE ME NDIHMËN E LUGËS DHE QESKËS*

Çfarë duhet të bëni: Me skajin e lugës gërryeni majën e gjuhës sa më thellë që mundeni, deri te pjesa e fundit e gjuhës. Mbylleni lugën në qese plastike dhe lëreni nën dritën e llambës një minutë, pastaj merrni erë.



*ERA E PEMËVE MUND TË TREGOJË KETOACIDOZËN (QË MUND TË JETË SHENJË E DIABETIT).*

Lyerja e gjuhës duhet të jetë e pastër, mirëpo nëse është e dendur, e ngjyrosur ose ka aromë të pakëndshme, kjo mund të jetë shenjë e hershme e problemeve me sistemin respirator, mëlçinë, veshkat, çrregullimin e punës së hormoneve ose të zorrëve. Aroma e amoniakut mund të tregojë problemet me veshkat, ndërkaq aromat e pakëndshme mund të tregojnë problemet me lukthin dhe mushkëritë.

Mirëpo, hulumtimet tregojnë që në 90 për qind të rasteve era e keqe nga goja tregon sëmundje më pak të këqija, siç janë sëmundjet e mishit të dhëmbëve, blombave të dëmtuara të dhëmbëve ose kariesin, prandaj sa më parë shkoni te stomatologu.

Ky test njëkohësisht është treguesi më i afërt se si era juaj e keqe u duket të tjerëve.

*TESTI PËR ARTERIE TË MBYLLURA*

Shtrijuni në krevat dhe ngrini të dy këmbët në jastëk nën këndin prej 45 shkallëve. Mbani ashtu një minutë, pastaj shpejt shtrini poshtë në skajin e krevatit nën këndin prej 90 shkallësh. Nëse njëra apo të dy shputat zverdhen kur janë ngritura dhe u nevojiten disa minuta që t'u kthehet ngjyra normale e trëndafiltë ose bëhen ngjyrë të kuqe të shndritshme kur varen, kjo mund të tregojnë bllokimin e arterieve dhe rrezikun e shtuar nga sëmundjet e zemrës. Faktorët e rrezikut përfshijnë shtypjen e lartë të gjakut, nivelin e lartë të kolesterinës dhe diabetin.



Te personat e shëndetshëm ngjyra normale e trëndafiltë do të duhej të kthehej në afatin prej 10 deri në 30 sekonda.

*GROMËSIRA PËR KONTROLLIM TË THARTIRËS SË LUKTHIT*

Përzieni një lugë sodë bikarbonati në një gotë ujë nga çezma, përzieni dhe pini përnjëherë në lukth të zbrazët. Gromësira e zëshme në afat prej pesë minutash tregon nivele të shëndetshme të thartirës së lukthit. Në të vërtetë, përzierja e natriumit të bikarbonatit me thartirën e lukthit krijon reaksionin i cili shkakton gromësirën.

Nëse nuk ka reaksione të tilla, shkaku është niveli i ulët i thartirës së lukthit që te disa njerëz bie pas moshës së dyzetë, gjë që shkakton tretje të dobët dhe absorbim të dobët të materieve ushqyese. Nivelet e ulëta të thartirës mund të shkaktojnë djegësirën, prandaj shmangni përdorimin e tepruar të antacideve, sepse gjendja mund të bëhet edhe më e keqe.

*TESTI PËR DEMENCËN ME NDIHMËN E ORËS*

Vizatoni orën me dorë në një letër, shtoni numrat dhe bëni akrepat në orën 3.40. Çdo vështirësi e vizatimit të orës, nëse numrat nuk janë në radhën e duhur, mund të jetë shenjë e dëmtimit të dobët kognitiv ose të fillimit të demencës.

## "Sa me naze kërcen plaka!" deputetet e LSI-së ia marrin valles në Jalë

Deputetet e Lëvizjes Socialiste për Integrim i janë bashkuar të rinjve në kampin e LRI-së që ngrihet çdo vit në Jalë. Vallen me të rinjtë e kanë marrë deputetet Klajda Gjosha, Floida Kërpaçi si dhe Kejdi Mehmetaj, por dhe Endrit Braimllari. Në një mesazh përshëndetës kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi thumboi kryeministrin Rama dhe socialistët, të cilët edhe pse huazuan traditën me FRESSH nuk munden të "kopjojnë dot aksionin dhe motivimin.



## Ministrja shkon për të lindur me biçikletë: Nuk kishim vend në makinë



Në maternitet me biçikletë, në javën e 42-të të shtatzënisë. Këtë gjë e ka bërë Julie Genter, ministrja 38-vjeçare e Grave dhe Transporteve në Zelandën e Re, mbështetëse e flaktë e lëvizshmërisë me dy rrota, e cila solli në jetë fëmijën e parë. Pedalimi (me një biçikletë elektrike) deri në spitalin publik në Auckland, ku ajo kishte caktuar lindjen, mund të ketë lehtësuar procesin e lindjes. "Ishte kryesisht rrugë në ulje", komentoi nëna e re saj në faqen e saj të Instagram-it, ku paraqiti fotot e "udhëtimit" me burrin e saj. "Mëngjes i bukur këtë të diel për një xhiro në spital që më në fund të kem këtë vogëlush. Kjo është! Na uroni fat! Unë dhe partneri im morëm biçikletën, sepse s'kishte mjaftueshëm vend në makinë... Gjithsesi, kjo bëri që të jem në gjendjen time më të mirë!", shkruan politikania në 'Instagram'.

# BULEVARDI POLITIK

*Na merrni seriozisht!*

## Deputeti zhvishet në parlament, proteston kundër presidentit



Një ligjvënës i opozitës venezueliane pothuajse u zhvesh lakuriq gjatë një fjalimi emocional para Asamblesë Kombëtare të vendit. Gilber Caro, një anëtar i partisë opozitare të linjës së ashpër, Popular Will, bëri thirrje për unitet dhe mbështetje të Juan Requesens, një udhëheqësi opozitar i akuzuar dhe i burgosur për dyshimin se kishte një rol në një përpjekje për vrasjen e Presidentit Nikolas Maduro më 4 gusht, gjatë një feste ushtarake. Caro e vlerësoi Requesens si 'një djalë i shkëlqyer. Një djalë i ri që i dha të gjitha në rrugë. "Është momenti. Unë bëj thirrje për unitet në këtë institucion në mënyrë që ne të mund ta mbrojmë atë në mënyrën se si ai në rrugë mbrojti institucionet dhe lirinë e Venezuelës"- tha ai. Politikani për një çast u ndalua për të hequr pantallonat e tij dhe më pas fajësoi administratën e presidentit për heqjen e të drejtave të njeriut nga ushqimi dhe mjekësia. Gilber Caro kaloi vetë 17 muaj burgim pasi Maduro e akuzoi atë për kryerjen e sulmeve terroriste në vitin 2016, përpara se të rifitoi lirinë në qershor.

## Trump në "luftë" me mediat; 350 redaksi lajmesh i kundërpërgjigjen

Shtypi dhe zyra e presidentit të Shteteve të Bashkuara kanë pasur prej kohe lidhje të ngushta pune, ndonëse shpesh antagoniste, por që nga ardhja e presidentit Trump në Shtëpinë e Bardhë, marrëdhëniet janë bërë toksike. Presidenti Trump e ka cilësuar vazhdimisht median si "armik i popullit". Ai e ka cilësuar shtypin "të rrezikshëm dhe të sëmurë", madje ai është shprehur se gazetarët mund "të shkaktojnë luftë". Disa media amerikane po deklarojnë se janë ngopur me retorikën e presidentit, të cilën ata e dënojnë si të rrezikshme. Gazeta në mbarë vendin po i kundërvihen presidentit, përmes një fushate editoriale të paparë dhe të koordinuar, duke botuar sot artikuj redaksionalë mbi lirinë e shtypit. Nisma ishte e gazetës The Boston Globe, e cila deklaroi se "lufta e fëlliqur ndaj shtypit duhet të marrë fund". Sipas gazetës, 350 media i janë bashkuar nismës së saj.



Ish-i dërguari i BE-së për Kosovën: KE do t'i përkasë së shkuarës

# Wolfgang Petritsch: Mund të ketë korrigjim 'kozmetik' të kufijve

## "Dialogu me Serbinë, duhet ndërtuar një dokument obligues"

Wolfgang Petritsch, ish-i dërguar i veçantë i BE-së për Kosovën, është shprehur se ka frikë nga konflikti i ngrirë në Kosovë dhe le mundësinë edhe për "korrigjim kozmetik të kufijve". "Vërtet, ekziston rreziku i konfliktit të ngrirë në Kosovë. Kjo do të ishte në interes të disa aktorëve politikë - edhe vendas edhe ndërkombëtarë - që të vazhdojnë t'i destabilizojnë shtetet në rajon. Hajde të bëjmë që të pengojmë këtë. KE, nën udhëheqjen e Junckerit, Mogherinit e Hahnit, së shpejti do të jetë 'çështje e së kaluarës'". "Në vitin 2019 janë zgjedhjet për Parlamentin Evropian dhe kam frikë se përbërja e re e Komisionit Evropian mund të shmangë të zgjedhë çështjen e Kosovës, sepse përbërja paraprake nuk e ka bërë këtë. Afati i përfundimit për të marrë vendim është, pra, me rëndësi esenciale",-ka thënë në bisedë për gazetën beogradase "Danas" Wolfgang Petritsch, ish-i dërguar i veçantë i BE-së për Kosovën dhe ish-përfaqësues i lartë i bashkësisë ndërkombëtare për BeH-në, i pyetur se çfarë do të thoshte konflikti i ngrirë për Beogradin e Prishtinën, transmeton gazetametro.net. I pyetur rreth deklaratës së tij të mëparshme për një "korrigjim kozmetik" si zgjidhje të mundshme për Kosovën dhe sqarimit të tij se kjo "do të kishte ndikim të vogël në një numër të "vogël" fshatrash në rrethinën e Bujanovcit dhe të Mitrovicës", si edhe rreth qëndrimit të Kancelares gjermane Angela Merkel, e cila fuqishëm kundërshton ndryshimin e kufijve në Ballkan, Petritsch thotë: "- Padyshim, fjala e Kancelares gjermane "ka peshë" dhe unë e respektoj mendimin e saj.


Wolfgang Petritsch, ish-i dërguar i BE-së për Kosovën

Megjithatë, duke pasur parasysh dialogun e komplikuar aktual ndërmjet Beogradit e Prishtinës unë tashmë jam i bindur se duhet t'i dëgjojmë me kujdes marrësit e vendimeve politike në këto dy kryeqytete. Edhe deri sa kam qenë përfaqësues i lartë në Bosnjë, jam angazhuar për proces të vetëpërgjegjësisë. Vetëm se së fundi është dëshmuar se kjo mund të "ndezë" në Maqedoni, kur kryeministri Zaev ka marrë vendim shumë të guximshëm - dhe shumë kontradiktor mbi emrin e shtetit. Greqisë e Maqedonisë u janë dashur 26 vjet për ta zgjidhur këtë konflikt historik - shpresoj se kjo do të jetë efikase. Tashmë na ka mbetur konflikti i fundit historik, ai ndërmjet serbëve e shqiptarëve dhe unë këtu shoh se po hapet një mundësi - ndoshta e fundit në shumë vite që vijnë. Jam krejtësisht i vetëdijshëm se "korrigjimi administrativ" i kufijve ka të meta potenciale në qoftë se nuk bëhet në bashkëpunim të ngushtë me OKB-në, BE-në e OSCE-në. Në dritën e referendumit të ardhshëm në Maqedoni dhe, është e mundur edhe vendimit të afërt në procesin e dialogut mes Beogradit e Prishtinës, propozoj që të përgatitet dokumenti obligues në mënyrë që të vihet pikë në të gjitha kontestet e ardhshme kufitare, duke përfshirë çështjen e Bosnjës. Siç e dimë, edhe më tej ekzistojnë disa mospajtime të vogla ndërmjet vendeve trashëgimtare të ish-Jugosllavisë, të cilat duhet të zgjidhen. Madje edhe shtetet anëtare të BE-së. Kroacia e Sllovenia, kanë "çështjen e tyre të Adriatikut". Prandaj, do të ishte rast i shkëlqyeshëm që të mbyllen të gjitha këto çështje të hapura dhe t'u jepet fund të gjitha fantazive revizioniste. Pse? Sepse situata gjeopolitike në Ballkan po ndryshon shpejt, dhe atë jo në dobi të Ballkanit. Ngritja e Kinës, e cila është e mirëseardhur në planin ekonomik, po i shkakton shqetësime të mëdha Brukselit, si dhe aktivitetet e aktorëve të tjerë jashtë BE-së, si Turqia, vendet e gjirit dhe, natyrisht, Rusisë. Po e përsëris - të gjitha këto janë të mirëseardhura t'i kontribuojnë zhvillimit ekonomik, por të gjitha shtetet e regjionit dëshirojnë të bëhen më shumë evropiane dhe, në fund, anëtare të Bashkimit Evropian. Prandaj, është e nevojshme që rregullat dhe rregulloret evropiane të jenë në plotësi të zbatueshme. Hajde, pra, t'i pyesim njerëzit, duke përfshirë edhe ata në pjesët potencialisht të goditura të Serbisë e Kosovës, e pastaj të marrim vendimin, i cili do të jetë në harmoni me parimet e multietnicitetit dhe parimeve të pranuara ndërkombëtarisht". Petritsch ka thënë se nuk ka kontakte personale me Vuçiçin e Thaçin, por se i ka lexuar disa nga deklaratat e tyre rreth korrigjimit të kufirit dhe fton "të përkrahen vendimet e guximshme politike, në emër të popujve të cilëve u përkasin". Ai nuk është i sigurt se a do të ketë zgjidhje të shpejtë, por shpreson se kjo iniciativë e tij personale të ndihmojë "që të merret vendimi i duhur". I pyetur se a mendon se edhe çështja e Kosovës mund të gjendet në një konferencë ndërkombëtare, të ashtuquajtur "Dayton dy", Petritsch mendon se në të duhet të përfshihet edhe Rusia: Siç kam thënë në njërën prej përgjigjeve të mija, mund të paramendoj një format të ngjashëm më Daytonin, dhe angazhohem që në të të përfshihet edhe Rusia, në mënyrë që njëherë e përgjithmonë të spastrohet situata e post-Jugosllavisë, si dhe që në tërësi të fokusohemi në çështje vitale politike e ekonomike dhe në të ardhmen e BE-së, e cila përfshin vendet e Ballkanit Perëndimor si partnerë të barabartë. Nëse jo Nobelin, ai pret që Thaçi e Vuçiç të mund të marrin çmimin e Karlit, të cilin çdo vit e ndan qyteti i Aachenit për shtetarët e shtetarët, të cilët kanë ndihmuar që të avancojë gjendja në Evropë.

Boçvej: Vendimi ka sjellë pengesë në marrëdhëniet tona

# Ministrat e Ganës dhe Serbisë takohen në Beograd: Do rishikohet njohja e Kosovës

Ditën e djeshme, Ministria e Punëve të Jashtme e Serbisë përmes një komunikate për media ka thënë se ministrja e Punëve të Jashtme dhe Integrimit Rajonal të Ganës, Shirli Boçvej, e cila po qëndron për vizitë zyrtare në Beograd, ka deklaruar se shteti i saj do të shqyrtojë vendimin për pranimin e pavarësisë së Kosovës. "E di se vendimi që është sjellë ka qenë pengesë për zhvillimin e marrëdhënieve tona. Por, ne jemi këtu, nuk kemi shkuar në Kosovë",-ka thënë Boçvej në një konferencë të përbashkët për gazetarë me homologun e saj serb, Ivica Daçiç. Duke u mbështetur në përvojën e të painkuadruarve dhe rolin që Gana dhe ish-Jugosllavia kanë luajtur në këtë lëvizje, Daçiçi ka theksuar se Serbia dhe Gana dëshirojnë që t'i "rindërtojnë marrëdhëniet e tyre, të cilat janë shkelur para 6 vjetësh me vendimin lidhur me njohjen e Kosovës". "Nuk dëshirojmë që të bëjmë presion dhe Kosova as që është tema kryesore e atyre për të cilat po flasim. Ky është vendim i tyre dhe ne do të donim që edhe një herë ta analizojnë situatën, e cila tash është shumë më ndryshe, sepse po hulumtohet për zgjidhjet dhe po zhvillohet dialogu. Do të donim që të rishqyrtohet vendimi, të cilin e ka sjellë administrata e mëparshme",-ka theksuar Daçiç, thuhet në komunikatën e Ministrisë së Jashtme të Serbisë. Ndërkaq, kryetari i parlamentit të Ganës, Ajron Majkl Okvaje, gjatë vizitës në Beograd, në muajin maj, ka deklaruar se Gana do ta shqyrtojë çështjen e pranimit të pavarësisë së Kosovës. Por, më 8 qershor, ambasadorja e emëruar e Ganës në Prishtinë, Salma Frances Mancell- Egalla, i ka dorëzuar letrën kredenciale ministrit të Punëve të Jashtme të qeverisë së Kosovës, Behgjet Pacolli. Edhe vetë ministri Pacolli, përmes rrjetit social 'Facebook', kishte njoftuar për akreditimin e ambasadores së re të Ganës në Kosovë.


Ivica Daçiç

**SHIRLI BOÇVEJ:**
"E di se vendimi që është sjellë ka qenë pengesë për zhvillimin e marrëdhënieve tona. Por, ne jemi këtu, nuk kemi shkuar në Kosovë", ka thënë Boçvej në një konferencë të përbashkët për gazetarë me homologun e saj serb, Ivica Daçiç.

SHKURT

## Katastrofa nga përmbytjet në Indi, mbi 410 viktima

Mbi një milionë persona janë zhvendosur për shkak të përmbytjeve të rënda në Kerala të Indisë. Ata janë dërguar në kampet e ndërtuara nga autoritetet. Një zëdhënës i qeverisë lokale të Keralës tha se bilanci i fatkeqësisë natyrore ka shkuar në 410 persona të vdekur. Ndërsa rreth 50 mijë banesa janë shkatërruar. Pas një jave të mbushur me shira të rrëmbyeshëm, kushtet meteorologjike janë përmirësuar. Kjo po lejon ekipet e shpëtimit që të intensifikojnë kërkimet për të mbijetuar. Ndërsa po shpërndahen ushqim dhe ujë në disa zona të tjera të prekura nga përmbytjet dhe rrëshqitjet e dheut.

## Tragjedi në një park malor në Kalabri, 10 viktima

10 turistë humbën jetën tragjikisht, mbrëmjen e të hënës teksa vizitonin një prej parqeve kombëtare më të famshëm turistikë të Kalabrisë. Një grup prej 36 ekskursionistësh u gjendën të papërgatitur mes shtigjeve të bregut të lumit, teksa një valë gjigande uji e balte u erdhi papritur mori përpara disa prej tyre. Krahas 10 viktimave, trupat e të cilëve u nxorën prej operacioneve të shpëtimit që vazhduan gjatë gjithë natës, 3 të tjerë rezultojnë të zhdukur. 11 persona mbetën të plagosur, mes të cilëve edhe një vajzë 14 vjeçare. 6 ndër të plagosurit janë në gjendje të rëndë në spital. Kërkimet për të zhdukurit po vijojnë intensivisht. Në shtratin e lumit ka mjaft gropa dhe shpella. Siç tregojnë dëshmitarët, ata që shpëtuan arritën të largohen këmbadorazi. Rryma e furishme e ujit shpërtheu papritur në lumë për shkak të reshjeve masive që bien vazhdimisht në zonë. Autoritetet e parkut kombëtar malor "Parko del Polino" i kishin njoftuar turistët për rrezikun e fryrjes së lumit. Megjithatë ata thonë se ngjarja ishte e paparashikueshme, pasi ditët e fundit nuk kishin konstatuar fryrje të rrjedhës së lumit, e aq më tepër kaq papritur. Krahas italianëve, mes grupeve të ekskursionistëve kishte dhe të huaj. Kërkimet për të zhdukurit në zonë, po vijojnë intensivisht. Për të shkuar tek vendi ku ndodhi tragjedia kalohet përmes atij që quhet "Shtegu i djallit", që në tabelat orientuese të zonës është e përkthyer edhe në shqip prej komunitetit arbëresh të Kalabrisë që banon aty.

ARKEOLOGJI

Arkeologët ringjallin pas gati 55 vitesh gërmime Kalanë e Palokastrës buzë Drinos, ndërsa shpresojnë se ndërtimi i imazhit 3D i sitit arkeologjik dhe gjetjet e fundit do shtojnë vizitorët në rrënojat antike dhe do të pasurojnë itinerarin e turistëve që dynden vetëm pak kilometra më tutje në qytetit muze të Gjirokastrës.

# Antikiteti në 3D: "Ringjallja" e Palokastrës u hap rrugën vizitorëve në luginën e Drinos

Raimond Kola





Pak kilometra nga Gjirokastra, nëse kthehesh në anën e djathtë të Urës së Kardhiqit, rruga të çon në një fushë të gjerë poshtë fshatit Palokastër. Në fushën buzë lumit, aty ku bashkohet përroi i Kardhiqit me Drinon shfaqen muret e kalasë me të njëjtin emër.

Në një sipërfaqe prej gati 1 hektarë brenda rrënojave të mureve, bimësia është pastruar dhe inxhinierët dhe arkeologët e kanë më të lehtë të skanojnë nëntokën, duke shtyrë me karrocë hap pas hapi pajisjen gjeofizike përmes disa rrugicave të kufizuara me shirita.

Prej muajsh një grup arkeologësh dhe studentësh italianë dhe shqiptarë gërmojnë në rrënojat e qytezës antike, ndërsa një tjetër grup inxhinierësh italianë po punon me fotografi dhe skanime të mureve rrethuese për të krijuar një profil në 3D të sitit arkeologjik.

Arkeologët shqiptarë dhe italianë shpresojnë që gjatë misioneve që do të vijojnë, do të krijojnë një kompleks të integruar të disa siteve arkeologjike dhe po ashtu edhe vizatojnë një hartë të lidhjeve funksionale mes tyre në luginën e Drinos. Përgjatë kësaj lugine, ku ata gërmojnë prej 13 vitesh gjenden gjurmë të 15 qendrave urbane të lashtësisë, të cilat ata shpresojnë që me kalimin e kohës të tërheqin jo vetëm studiuesit e trashëgimisë kulturore dhe arkeologët, por edhe turistët.

Lugina e Drinos sipas arkeologëve përmban gjurmët e një prej rrugëve më të rëndësishme të Ballkanit në kohët antike. Kjo është rruga që lidhte Apoloninë dhe Bylysin me qendrat e tjera të rëndësishme si Adrianopolin, Dodonën në pellgun e Janinës deri në Nikopol. Në krahun tjetër të Luginës së Drinos, rruga komunikonte përmes Qafës së Skërficës-sot Kardhiq- Delvinë me Foiniken (Finiqin), Onhesmin (Sarandën e sotme) dhe Buthrotin (Butrintin), ndërsa po nga kjo rrugë përmes zonës malore të Kurveleshit mbërrinte në Aulonë dhe Orik.



### GJETJET E REJA

Misioni i drejtuar nga drejtori i Institutit të Arkeologjisë, Luan Përzhita si dhe arkeologu Dhimitër Çondi për palën shqiptare dhe arkeologu Roberto Perna për palën italiane, së bashku me një grup inxhinierësh dhe specialistësh italianë të fushave të ndryshme, është përqendruar të zbulojë fortifikimet që kontrollonin Luginën e Drinos për të siguruar rrugët ushtarake dhe tregtare.

Arkeologu italian, Roberto Perna, profesor i universitetit të Maceratës thotë se "gërmimi më i rëndësishëm u kryе në Kalanë e Palokastrës".

"Janë shumë gjetje të reja",- thotë zoti Perna, ndër të cilat ai veçon zbulimin e një pllake në Kalanë e Palokastrës me një dedikim për Kishën Paleokastriane të shekullit të V dhe të VI, një strukturë fortifikuese romake dhe më tej një objekt që duket si shkollë e periudhës bizantine.

Ndërkohë, arkeologët thonë se kanë marrë informacione të reja edhe pas gërmimeve për vendbanimin e lashtë të Melanit. Gjithashtu, për të 13-in vit radhazi, kërkimet kanë vijuar këtë vit edhe në Teatrin e Adrianopolit pranë Sofratikës.

"Gjetjet e tjera në objekte më të vogla dëshmojnë për një periudhë intensive të jetës në këtë sit",-thotë arkeologu Perna. Sipas tij, të dhëna të rëndësishme vijnë këtë vit edhe në drejtimin e dytë të kërkimeve në vendbanimin e Melanit.

"Është bërë zbulimi i fortifikimeve të reja të periudhës helenistike dhe bizantine në Melan, duke e futur këtë vendbanim në hartën e siteve të rëndësishme arkeologjike të Luginës së Drinos",- thotë ai.

Ndërsa arkeologu Dhimitër Çondi thotë se në Melan gërmimi ka dhënë këtë vit një statigrafi kronologjike të jetës së qytetit.

"Strukturat e reja që kanë dalë në dritë janë konsoliduar dhe vitin tjetër pritet të vijohet me gërmime të reja", thotë ai.

Edhe gërmimet në Palokastër kanë qenë intensive që prej ekspeditës së fundit në këtë zonë nga arkeologut Apollon Baçe në vitin 1974.

"Krahas evidentimit me pajisjet gjeofizike të të gjitha rrënojave nën tokë, është gjetur, gjithashtu, shumë qeramikë dhe kjo flet se vendbanimi ka pasur poçari të zhvilluar ashtu si mund të ketë pasur edhe një akuadokt (ujësjellës) për furnizimin me ujë," thotë arkeologu Melsi Labi, përgjegjës i gërmimeve në këtë zonë.

Por sipas tij, zbulimi i pllakës së Kishës në Palokastër gjatë gërmimeve ka qenë "qershia mbi tortë". "Është një detaj mjaft i rëndësishëm i gërmimeve që do t`i ndihmojë specialistët të hedhin dritë edhe mbi datimin e kishës, bazuar në analizimin e shkrimit dhe të përbërjes së pllakës",- thotë Labi, i cili ushqen po ashtu dëshirën që kalaja të bëhet shpejt e vizitueshme.

Majori anglez, U.M.Lik ishte i pari që e vizitori Kalanë e Palokastrës duke e datuar ndërtimin e saj në periudhën e antikitetit të vonë. Sipas arkeologut Neritan Ceka, Lik njoftoi se rrënojat quheshin nga vendasit "Drinopol". Arkeologu shqiptar, Apollon Baçe punoi në vitet '74 –'76 me një ekspeditë, duke hedhur dritë mbi përmasat e sitit. Arkeologu gërmoi në Kalanë në formë trapezi me një sipërfaqe rreth 1 ha, e barabartë për të mbajtur brenda vetes së saj një legjion romak me rreth 1000 ushtarë. Gjatë gërmimeve të 1974, kryesisht në pjesën perëndimore, në gusht të atij viti u zbuluan themelet e kapanoneve të ushtarëve, një bazilikë paleokristiane dhe 8 ambientet e kullave.

Një vit më vonë, në gusht të 1975, u pastrua ana lindore dhe jugore dhe u zbuluan 16 varre ndërsa në gusht të vitit 1976 u pastrua ana veriore dhe filluan punimet e konsolidimit dhe konservimit për kullat, kishat dhe varret. Kalaja kishte katër hyrje dhe 14 kulla. Hyrja kryesore u zbulua në mesin e Kalasë ku kalonte rruga kryesore gjatë sundimit romak-bizantin.

### NJË QYTET ANTIK NË 3D

Përgjegjësi i gërmimit arkeologjike në Palokastër, Melsi Labi thotë se pajisjet e reja gjeofizike dhe përvoja e inxhinierëve italianë, pjesë e misionit, kanë qenë mjaft të dobishme për të "lexuar" nëntokën e kalasë së Palokastës ku ndodhen disa rrënoja godinash.

"Siti është konturuar, gërmimet kanë nxjerrë në dritë mjaft nga rrënojat. Janë edhe disa kushte të tjera të favorshme për të tërhequr vizitorët"-thotë Labi. Ai përmend afrinë me qytetin e Gjirokastrës, qytet i UNESCO-s, por edhe vendbanimet e tjera të hershme në luginë.

"Kalaja është vetëm 1 km larg rrugës kombëtare Tepelenë- Gjirokastër në Urën e Kardhiqit, siti i ri është mjaft komod për t'u vizituar pasi shtrihet në një hapësirë të gjerë gati një hektarë dhe peizazhet natyrore të zonës janë mbresëlënëse"-shtoi ai, ndërsa theksoi se zonës sidoqoftë i duhen ndërhyrje në infrastrukturë.

Romina Nespik, inxhinierja nga Universiteti Politeknik i Ankonas thotë se rikrijimi në 3D i një modeli të jetës dhe objekteve në këtë sit, do të ndihmojë shumë vizitueshmërinë e tij. "Ndihma do të jetë e madhe jo vetëm për specialistët, por edhe në aspektin turistik, pasi vizitorët do të kenë mundësinë të prekin në 3D pamje të kalasë së ndërtuar mbi bazë të informacionit historik",- thotë Romina.

E ndodhur fare pranë qytetit antik të Antigonesë, teatrit të Sofratikës, Melanit dhe rrënojave të tjera arkeologjike, së fundmi edhe Kalaja e Palokastrës mund të bëhet pjesë e guidave të udhëtimeve të vizitorëve vendas dhe të huaj, duke shërbyer edhe si nxitje për zhvillimin ekonomik të këtyre zonave.

"Vizitorët italianë mbeten shumë të interesuar",- thotë Teodor Bilushi, konsulli i nderit të Italisë në Gjirokastër. "Ka një rritje të madhe të numrit të turistëve italianë këtë vit dhe sidomos në sitet kulturore",-shtoi ai.

Dje në "Deutsche Welle"

# Shansi i dytë i Greqisë

Nga Bernd Riegert

*(vijon nga faqja 1)*


© picture alliance/dpa/O. Panagiotou

… për falimentim Greqi, me gjithë gabimet që u bënë dhe me të gjitha momentet e vështira, që iu desh të kalonte popullit grek, është një sukses për Bashkimin Evropian dhe veçanërisht për shtetet e komunitetit të euro-s.

Kur më 2010 u bë e dukshme që shteti grek, përmes deficiteve shumë të larta, produktivitetit të ulët, pagave shumë të larta dhe konsumit privat tej mundësive, ndodhej në buzë të falimentimit, Europa dhe Fondi Monetar ndërkombëtar vendosën që t'i ndihmojnë grekët. Për këtë nuk do të kishin qenë të detyruar. Marrëveshjet europiane e përjashtojnë një "bailout" shprehimisht. Prandaj u ra dakord që Greqia të ndihmohet me kushte jashtëzakonisht të favorshme, në mënyrë që të kishte mundësi të plotësonte detyrimet e saj, për shembull të paguante rrogat e të punësuarve në shtet dhe pensionet.

Natyrisht që Eurozona nuk e bëri këtë hap vetëm për solidaritet, por edhe për interes vetjak, që të pengonte kalimin e krizës në pjesën tjetër të komunitetit monetar. Po, u morën masa që edhe bankat në Gjermani, në Francë dhe në Spanjë të mos falimentonin dhe të përfundonin në humnerë së bashku me Greqinë. Por: shtetet e eurozonës dhe FMN mund të kishin vepruar edhe ndryshe, mund t'i kishin dëgjuar thirrjet e Kasandras se shpëtimi i Greqisë nuk do të jetë kurrë i mundur.

**MASA SHUMË TË ASHPRA, POR PA ALTERNATIVË**

Pa kushte të ashpra, mëkëmbja financiare e Greqisë nuk do të kishte qenë e mundur. Shteti qe i detyruar t'i ulte në mënyrë drastike shpenzimet e tij të tepruara. Populli hoqi dorë nga të ardhura. Ekonomia u rrudh. Të gjitha këto masa të ashpra qenë të pashmangshme, sepse një jetë si më parë me borxhe, nuk qe e mundur të ecej më. Por në retrospektivë mund të thuash se shkurtimet mund të qenë organizuar me pasoja sociale më të durueshme për popullin. Kushtet qenë të nevojshme edhe për ta detyruar shtetin dhe ekonominë që të ndërmerrte reforma strukturore, të cilat nuk qe e mundur që të ndërmerreshin për dekada në Greqi. Kritikët e shumtë, që pohojnë herë pas here, se kreditorët e shkatërruan Greqinë me kursime, e kanë gabim. Pa masat rimëkëmbëse Greqia nuk do ta kishte ecur dot më përpara dhe do të qe shkatërruar shumë shpejt - pra do të kishte dalë nga Eurozona, e shkëputur krejtësisht nga burime financiare të çdo lloji.

Kryeministri populist i djathtë, Aleksis Cipras, që tani e lë veten ta festojnë si çlirues nga zgjedha e Trojkës e kuptoi këtë mjaft shpejt. Për disa muaj ai luajti rolin e kryengritësit të majtë, u ngrit së bashku me ministrin e tij të Financave me sjellje kllouni, Janis Varufakis kundër donatorëve. Në vitin 2015 ai e çoi vendin në kufi të paaftësisë për të paguar. Pas vështrimit në humnerë, Ciprasi mori kthesën dhe urdhëroi masa kursimi më të ashpra se kurrë më parë. Ngriti taksat, por njëkohësisht uli ritmin e reformave. Në tërësi ai u përshtat me kursin e shpëtimit të Eurozonës dhe këtë e shet tani si fitore. Se pse ia besojnë grekët këtë, kjo mbetet çudi.

**DYSHIM NË AFTËSINË PËR TË REZISTUAR TË GREQISË**

Sido që të jetë, aventurat e Ciprasit dhe të Varufakisit i kushtuan vendit gati tri vjet të tjera nën ombrellën e shpëtimit dhe një rënie të rendimentit ekonomik. Tani ekonomia dalëngadalë po bën sërish përpjetë. Kjo nuk ka lidhje me idetë e qeverisë radikale të majtë në Athinë, por me kursin e peshuar të europianëve. Që prej 21 gushtit, Greqia duhet të përballet sërish e vetme në tregjet financiare dhe të përpiqet të huazojë para me interesa të përballueshme. Kjo mund të dalë mbarë, vetëm kur çdo qeveri greke, e cila do të vijë në të ardhmen në pushtet, t'i përmbahet në mënyrë të hekurt disiplinës buxhetore dhe ta përmirësojë aftësinë për konkurrencë të vendit. Shansi i dytë, që ka Greqia tani, është fituar me mundim. Ai nuk duhet hedhur dëm.



Opinioni i Ditës

# Lira turke, euro dhe dollari i fortë

Nga Fatos Çoçoli

*(vijon nga faqja 1)*



… prodhim të brendshëm bruto të vendit 849.5 miliardë dollarë amerikanë në vitin 2017. Problemet e ekonomisë së saj duhet t'i shikojmë me shumë kujdes, se mund të prekin edhe ekonominë tonë. Ekonomia turke ka kohë që vuan nga një deficit tregtar kronik (importon gati tërësisht naftë dhe metale) dhe përbënte një rast ekstrem vendi deficitar edhe përpara se sa Erdogan, njeriu i fortë i sotëm i saj, të ngjitej në pushtet në vitin 2002. Megjithatë, për shkak të krizës botërore të vitit 2008 dhe uljes së normës së interesit të dollarit nga banka qendrore e SHBA-ve, Rezerva Federale, vendet me ekonomi në ngritje si Turqia, India, Indonezia, Brazili etj., u konsideruan si parajsa të qeta në vitin 2009 nga shumë investues të huaj strategjikë dhe kapitali e kreditë vërshuan lumë në to. Në atë kohë, Erdogan tregohej tolerant dhe premtonte përpjekje tërësore për t'u bërë vend anëtar i Bashkimit Europian. Por gjithçka ndryshoi me përpjekjen për grusht shteti në korrik 2016 në Turqi. Me dhjetëra mijëra arrestime dhe burgosje, me dy vjet gjendje të jashtëzakonshme, ende të pa hequr pas fitores presidenciale në qershor 2018, investuesit e huaj gradualisht u larguan nga ky vend, madje edhe shumë pasanikë dhe investues vendas. Ekonomia turke vijoi të rritej për inerci me 7.5 përqind edhe një vit më parë, në 2017-en, por ishte një rritje jo e shëndetshme, e bazuar vetëm nga bumi i ndërtimeve qeveritare me kredi nga jashtë. Tani kjo ekonomi, sidomos qeveria turke, e ka shumë të vështirë të sigurojë kredi nga jashtë. Kjo, për arsye se monedha vendase, lira turke këmbehet me gati gjysmën (45 përqind më pak) të vlerës së saj të tetë muajve më parë, në janar 2018, kreditë e mëdha kryesisht në dollarë, nga shitje brenda vendit me një inflacion afro 16 përqind në vit dhe një zhvlerësim të tillë katastrofik të monedhës. Banka qendrore e vendit, Banka Qendrore e Republikës së Turqisë, humbi një rast të papërsëritshëm në 24 korrik 2018, për të qetësuar tregjet dhe investuesit, nëpërmjet rritjes së normës së saj të interesit. Duhej ta rriste të paktën 5 ose 8 përqind. Nuk e rriti, sikurse prisnin të gjithë dhe sikurse dukej se premtonte për masa të duhura edhe dhëndri i Presidentit Erdogan me origjinë shqiptare, ministri i sotëm i Financave dhe i Thesarit i Turqisë, Berat Albajrak. E frikësuar nga fiksimi i Erdogan se "norma e lartë e interesit është nëna e të gjitha të këqijave!", banka qendrore turke u mposht nga politika dhe në ditën kur thirrej për të ndihmuar vendin, cedoi. Tani Albajrak po përpiqet të ndihmojë ekonominë me një plan masash të forta që banka qendrore turke deklaroi më 13 gusht 2018, por nga deriçka. Nuk e ka rritur normën e interesit, fiksimin e Erdogan, por ka ndërprerë, që nga 15 gushti 2018, dhënien e huave bankave të nivelit të dytë përmes ankandeve të zakonshme të parave( një javore me 17.75 për qind interes), duke i detyruar ato të marrin hua brenda 24 orëve (hua njëditore) me 19.25 për qind, duke e rritur praktikisht normën e interesit ose çmimin e financimit me 1.5 përqind. Mirëpo edhe plani i masave, edhe kjo rritje e padeklaruar(ose e kamufluar) e normës së interesit jo në masën e duhur, si zor ta shpëtojnë lirën turke dhe të qetësojnë tregjet dhe investuesit, me gjithë marrëveshjen "Currency Swap" (shkëmbim valutash) që banka qendrore turke nënshkroi dy ditë më parë me atë të Kuvajtit. Ekonomia turke këtë vit si zor të rritet. Kryesorja është të shpëtojë nga një ulje ekonomike(recesion) e thellë. Problemet e saj duket sikur nuk kanë lënë pa prekur pak edhe euron. Bankat kryesore spanjolle, franceze dhe italiane i kanë dhënë para pa hesap kompanive dhe qeverise turke gjatë periudhës 2009-2016. Bankat spanjolle kanë dhënë 83.3 miliardë dollarë kredi, ndërsa ato franceze 38.4 miliardë dollarë dhe bankat italiane 17 miliardë dollarë. Edhe pse euro në Eurozonë është ulur pak në këmbim, si rezultat i krizës turke, tek ne ajo qëndron stabël, si rezultat i ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë. Me ikjen e emigrantëve që erdhën për të pushuar, presionet ndaj zhvlerësimit të euros tek ne do të largohen pak dhe euro mund të stabilizohet në këmbim një euro një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë lekë të vjetra. Si rezultat i rritjes së normës së interesit nga Rezerva Federale Amerikane dhe politikës së Trump për të tërhequr investuesit botërorë në SHBA, dollari do të vijojë të rritet në tregjet botërore, si edhe tek ne. Kjo nuk ka pse të na shqetësojë, pse ne importojmë në euro nga vendet e Eurozonës dhe banka jonë qendrore nuk ka pse të shesë dollarë, që të ulë vlerën e këmbimit të monedhës amerikane në tregun tonë. Sido që të jetë, dollari amerikan është në rritje të pandërprerë në të gjitha tregjet.

## HOROSKOPI

### DASHI
Duhet të tregoni kujdes për situatën financiare. Disa blerje, të cilat nuk ju nevojiten duhet që t'i shmangni. Nëse po planifikon që të bëni një udhëtim, anulojeni.

### DEMI
Mund të keni disa pasiguri të vogla ekonomike sot. Pesimizmi karakterizon shenjën tuaj, por është diçka kalimtare. Energjia pozitive do të jetë sërish me ju.

### BINJAKET
Ofertat për pune nuk do të mungojnë në këtë ditë. Përpiquni që të bëni zgjedhjen e duhur duke u këshilluar edhe me një person që ka më shumë eksperience.

### GAFORJA
Jeni pak konfuz sot. Veçanërisht në çështjet e dashurisë po tregoni pak pasiguri. Kjo ju bën të reagoni keq dhe ju fut në vështirësi përballë partnerit.

### LUANI
Prej disa ditësh nuk jeni në gjendje të mire shpirtërore. Vetmia është bërë kryefjalë për të lindurit në shenjën tuaj. Mos harroni se jeni shenjë e fortë dhe mund t'i tejkaloni të gjitha vështirësitë.

### VIRGJERESHA
Nëse merreni me një biznes apo keni bërë një investim, gjasat janë që jeni i pakënaqur me rezultatet. Mos prisni që të siguroni fitime brenda ditës. Jepini kohë vetes.

### PESHORJA
Ka ardhur koha që të mendoni më shumë për veten tuaj. Në dashuri duhet të investoni më shumë. Mos kaloni shumë kohë brenda ambienteve të shtëpisë.

### AKREPI
Ajo që ju nevojitet më shumë në këto momente është një mik besnik. Prej kohësh jeni ndjere i tradhtuar nga njerëzit që ju rrethojnë. Situata nuk duket shumë pozitive në këtë drejtim.

### SHIGJETARI
Keni lënë pas dorë njerëzit që ju duan dhe kujdesen më shumë për ju. Nëse ky është rasti edhe për ju si person, ndryshoni menjëherë sepse do të zhyteshit në një gabim të madh.

### BRICJAPI
Keni nevojë për vëmendjen e dikujt. Kjo ju bën që të ndërmerrni disa veprime të dëshpëruara, të cilat mund t'ju dëmtojnë, veçanërisht reputacionin tuaj.

### UJORI
Nëse nuk i zgjidhni vetë problemet tuaja, askush nuk ka për të zgjidhur ato. Veproni tani sa jeni në kohë dhe do të ndiheni i kënaqur me rezultatin.

### PESHQIT
Nëse fati nuk ka qenë me ju në lidhje me paratë, kjo do të thotë se ju duhet të hyni në aksion të menjëhershëm. Mos ia lini gjërat rastësisë veçanërisht kur bëhet fjalë për çështjet ekonomike.

## BASTI ME PRESIDENTIN



## Një Lambo për Klajvert nëse shënon 10 gola

Xhastin Klajvert ka fituar menjëherë zemrat e tifozëve të Romës, të cilët mendojnë se tani kanë në radhët e ekipit të tyre një lojtar, i cili në të ardhmen do të jetë një nga yjet e futbollit botëror. Por ai që është entuziazmuar më shumë nga futbollisti është vetë presidenti i klubit italian, Xhejms Palota. Ky i fundit, pasi e ka parë në veprim në SHBA gjatë turneut të fazës përgatitore, mësohet se i ka bërë një premtim shumë unik. "Nëse shënon 10 gola, do të të dhuroj një makinë", ishin asokohe fjalët e presidentit. Me të qeshur, ai i premtoi një Mercedes djaloshit të ri, por pastaj i entuziazmuar edhe më shumë nga gatishmëria e lojtarit për t'u bërë protagonist i këtij basti, vendosi që si "shpërblim të vinte një Lamborghini e re. Xhastin Klajvert luan si mesfushor ofensiv në krah dhe duke parë moshën e re, nuk do të jetë e lehtë që të shënojë 10 gola në këtë sezon në Serinë A. Gjithsesi, futbollisti ka pranuar me kënaqësi sfidën, me shpresën që të thyejë që këtë edicion rekordin e rij prej 12 gola në 44 ndeshje të shtrira në dy edicione me Ajaksin.



Jeton Selimi

### Anësori i majtë rrëfen objektivat e sezonit të ri, ku dëshiron titullin kampion

# Rrumbullaku: Qëndroj në Kukës dhe një vit

## *Mbrojtësi ka peng Ligën e Europës*

Pak ditë më parë, mbrojtësi i Kukësit, Simon Rrumbullaku ka rinovuar kontratën me Kukësin edhe për një vit, duke treguar kështu besnikëri pavarësisht se shumë zëra të merkatos e shihni Rrumbullakun larg Kukësit. "Me Kukësin kam rinovuar dhe do të jem pjesë e skuadrës edhe për një vit. Me bindi besimi që kanë treguar te unë të gjithë këtu nga i pari te i fundit gjatë këtij një viti e gjysmë që kam qëndruar. Presidenti është një njeri shumë dashamirës dhe kjo gjë pati shumë ndikim te unë, por edhe vetë unë ndihem mirë këtu dhe dëshira ime ishte të qëndroja. Kemi një grup të mirë me lojtarë cilësorë dhe natyrisht që kemi sërish pretendime për të qenë kampion këtë vit. Zhvilluam ndeshje të mira në Europë dhe kjo e ka rritur më shumë besimin brenda grupit. Kampionati ka një nivel të mirë me shumë konkurrencë dhe kjo e bën që të kemi më shumë punë dhe na e vështirëson pak punën tonë automatikisht. Pavarësisht vështirësive, është normale që të ketë konkurrencë pasi ajo na ndihmon më shumë", u shpreh Rrumbullaku për "Vip Sport".

I pyetur për objektivat që ka personalisht këtë sezon, Rrumbullaku me modesti shprehet se do të vazhdojë të bëjë atë që ai di të bëjë më mirë me shpresën që mund të ndihmojë skuadrën në arritjen e objektivave. "Unë personalisht do të vazhdoj të bëj atë që di më mirë, të stërvitem ne maksimumin tim. Kur të më jepet mundësia nga stafi që të aktivizohem dua të bëj punën time sa më mirë për të ndihmuar grupin në radhë të parë dhe në radhë të dytë klubin që të arrijmë objektivin madhor që është titulli pasi i kemi mundësitë. Shpresoj të kemi një vit të mbarë futbollistik",-shtoi mbrojtësi.




Ecuria në Kupat e Europës, nuk ishte ndër më të mirat për Kukësin duke qenë se objektiv ishin grupet e Ligës së Europës, por Torpedoja arriti të kalonte në turin tjetër duke eliminuar verilindorët në turin e tretë. Në lidhje me këtë ecuri, Rrumbullaku ka bërë edhe një krahasim mes ndeshjeve të kampionatit dhe atyre në Europë. "Kupat e Europës janë diçka krejt ndryshe, pasi ka ekipe të forta me buxhete shumë të mëdha, që investojnë dhe marrin lojtarë që bëjnë diferencën. Aty rritet edhe vlera e ekipit plus që është konkurrenca e madhe. Ne u munduam me çdo kusht të kualifikoheshim ndaj Torpedos. Nuk e arritëm atë gjë dhe kjo na mërziti, por nuk kemi çfarë të bëjmë pasi kështu e ka futbolli. Duhet të vazhdojmë të shohim para, të përmirësohemi dhe të tregojmë vlerat në kampionatin shqiptar, pasi të gjitha skuadrat duan të fitojnë ndaj Kukësit. Duhet vetëm të japim maksimumin", përfundoi Rrumbullaku.



## Bajerni përgatit një goditje të madhe në merkato

Shumë pak ditë kanë mbetur nga mbyllja e merkatos përfundimisht në Europë, ndërkohë që shumë kampionate e kanë mbyllur zyrtarisht. Në kushte të tilla, disa skuadra kanë mbetur të pakënaqura nga afrimet e bëra deri më tani dhe kanë filluar që të mendojnë për merkaton e verës së vitit tjetër. Bajern Mynihu është një ndër ekipet që ka bërë edhe planin se kë lojtarë do të afrojë në skuadër. Sipas gazetës gjermane "Bild", bavarezët do të tentojnë të afrojnë në "Allianz Arena" sulmuesin e Atletikos, Antuan Grizman. Për sulmuesin francez, drejtuesit e Bajernit janë të gatshëm të ofrojnë plot 200 milionë euro. Një tjetër emër i mundshëm për merkaton e Bajernit, është edhe ylli argjentinas i Juventusit, Paulo Dibala për të cilin bavarezët shpresojnë që të paguajnë më pak se për Grizmanin. Natyrisht, deri në verë tjetër mund të ndryshojë gjithçka, duke qenë se pas disa muajsh, është merkatoja e dimrit dhe mund të ketë lëvizje.

## MESFUSHORI

## Pjaniç rinovon me Juventusin deri në vitin 2023

Miralem Pjaniç do të vazhdojë të jetë një futbollist i Juventusit edhe për pesë vitet e ardhshme, pasi klubi italian ka zyrtarizuar rinovimin me mesfushorin boshnjak deri në vitin 2023, duke larguar kësisoj pretendentët për futbollistin. Gjatë verës u hapën zërat se për të interesohej si Pep Guardiola i cili kërkonte ta afronte te Mançester Siti, ashtu edhe Barcelona, në kërkim të një organizatori të mirëfilltë në mesfushë pas lamtumirës së Ineistës. Por me rinovimin e djeshëm, Juventusi ka bërë të qartë se ai do të vazhdojë të jetë pjesë e projektit bardhezi që ka si objektiv dominimin në Europë dhe dëshiron që ai të luajë përkrah Ronaldos. Pjaniç u afrua te Juventusi vetëm 2 vite më parë, pasi bardhezinjtë paguan klauzolën e largimit të tij te Roma. Por ai tregoi menjëherë se është një prej blerjeve më të suksesshme të klubit, pasi që atëherë ka dhënë 17 asiste te Juventusi, si dhe ka krijuar 120 raste të rrezikshme para portës kundërshtare, si askush tjetër në këtë klub.

## SITUATA

## "Rusi 2018", 100 tifozë vijojnë të kërkojnë azil

Botërori i Rusisë që u zhvillua këtë verë, ka qenë ndër më të çuditshmit, si në ndeshjet e futbollit, ashtu edhet jashtë stadiumeve. Shpesh herë, ndeshjet janë shoqëruar nga komente të shumta, të cilat nuk lidheshin vetëm me lojën që zhvillohej por edhe me shumë detaje të tjera, si tifozët apo edhe mungesa e birrave e pikturat e ndryshme nëpër mure pallatesh. Megjithëse Kupa e Botës ka më shumë se 1 muaj që ka përfunduar, çudirat vazhdojnë të jenë prezente duke qenë se "Moscow Times" raporton se janë rreth 100 persona nga vendeve të ndryshme, që kanë hyrë në rusi si tifozë dhe kanë kërkuar azil politik për t'i shpëtuar luftës që po zhvillohet në shtetet e tyre. Lajmi u konfirmua nga vetë këshilltarja për çështjet e emigracionit, Varvara Tretiak, e cila pranon se Botërori ka ndihmuar njerëzit për të hyrë në Rusi dhe tashmë kërkojnë azil por që shanset për ta përfituar, janë thuajse zero. Kryesisht, tifozët janë nga Somalia, Nigeria, Bangladeshi, Jemeni e Afganistani.


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al